

RAPORTI VJETOR

2025



**GJYKATA
KUSHTETUESE**



RAPORTI VJETOR

2025

© E drejta e autorit
Gjykata Kushtetuese

Shtypur në shktyshkronjën Onufri

ISBN 978-9928-861-28-3



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Tiranë, Shqipëri



+355 4 22 31 603



www.gjykatakushtetuese.gov.al



gjykata.kushtetuese@gjk.gov.al



[Gjykata Kushtetuese
e Republikës së Shqipërisë](#)



[@GjKushtetuese](#)



[Gjykata Kushtetuese
e Republikës së Shqipërisë](#)



[Gjykata Kushtetuese](#)

Përmbajtja

Mesazh i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Fiona Papajorgji	6
Një vit arritje dhe sfida	9
2025 në shifra	14
Përbërja e Gjykatës Kushtetuese	17
Struktura organizative dhe buxheti	20
Jurisprudenca kushtetuese në fokus	22
Veprimtaria gjyqësore: Statistika	50
Perspektiva ndërkombëtare	60
Partnerët ndërkombëtarë	61
Përfaqësimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	62
Data të rëndësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar	71
Aktivitete brenda vendit	72

Mesazh i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Fiona Papajorgji



Kam kënaqësinë të ndaj me ju arritjet që shënoi Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2025, por edhe sfidat që e shoqëruan atë.

Gjykata Kushtetuese i ushtroi funksionet në një kontekst juridik dhe institucional të karakterizuar nga kompleksiteti i çështjeve kushtetuese, numri në rritje i tyre, si dhe nga pritshmëritë e larta për një drejtësi kushtetuese të qëndrueshme dhe të besueshme.

Gjatë 2025-ës Gjykata dha 429 vendime të arsyetuara, prej të cilave 85 vendime përfundimtare, 316 vendime moskalimi të kolegjeve dhe 28 vendime moskalimi të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Megjithatë, përtej shifrave, veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese merr rëndësi kur ka ndikim real në jetën e individëve dhe në garantimin e shtetit të së drejtës.

Çështjet e shqyrtuara kanë prekur problematika me rëndësi të veçantë për rendin kushtetues, si funksionimi i pushteteve publike, mandatet e organeve të qeverisjes vendore, ripërtëritja e Gjykatës Kushtetuese, si dhe garantimi efektiv i të drejtave themelore të njeriut.

Sfidat e reja dhe komplekse që po sjell zhvillimi i vazhdueshëm i shoqërisë nuk kanë munguar të bëhen pjesë e jurisprundencës kushtetuese. Ato kanë qenë të lidhura me zhvillimet teknologjike dhe nevojën për rregullimin e platformave digjitale, balancimin e lirisë së shprehjes dhe interesit publik ose me mbrojtjen e mjedisit dhe zonave të mbrojtura.

Kushtetuta mishëron një rend vlerash të përqendruara te dinjiteti njerëzor. Në këtë kuptim, Gjykata është përpjekur të konsolidojë edhe dimensionin e ri të jurisprundencës kushtetuese që lidhet me kontrollin substancial të të drejtave dhe lirive themelore, në kuadër të të cilit garantimi i dinjitetit njerëzor dhe rritja e aksesit të qytetarëve përmes ankimit kushtetues individual mbeten prioritet.

Vëmendje të veçantë dua t'i kushtoj cilësisë së arsyetimit kushtetues dhe konsolidimit të jurisprudencës, pasi vendimet e Gjykatës shërbejnë për zgjidhjen e çështjeve konkrete, por edhe si udhërrëfyes për institucionet shtetërore, gjykatat dhe shoqërinë në tërësi. Në këtë drejtim, Gjykata është fokusuar në forcimin e kapaciteteve të kërkimit dhe arsyetimit ligjor, si dhe ka synuar të zhvillojë më tej dialogun kushtetues, duke u mbështetur në parimet e së drejtës krahasuese dhe në praktikën gjyqësore ndërkombëtare, në funksion të pasurimit të analizës kushtetuese.

Gjatë vitit 2025 përparime të dukshme janë shënuar në lidhje me transparencën, komunikimin e hapur me publikun, si dhe publikimin sistematik të vendimeve e përmbledhjeve të tyre. Këto arritje janë fryt i angazhimit dhe përkushtimit të vazhdueshëm e të pakursyer të gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë dhe administratës së Gjykatës Kushtetuese, që kanë kontribuar në përmbushjen e misionit dhe funksioneve kushtetuese të institucionit.

Dialogu dhe solidariteti gjyqësor kanë qenë gjithashtu në fokusin parësor të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim, dua të theksoj se viti 2025 shënoi një moment me rëndësi të veçantë për Gjykatën si kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC) për periudhën 2024–2027, përmes organizimit në Tiranë, më 28 shkurt 2025, të Takimit Përgatitor të Rrethit të Kryetarëve të CECC-it.

Në rrugëtimin e saj gjatë vitit 2025 Gjykata Kushtetuese nuk ka qenë e vetme, prandaj

mirënjohje të veçantë shpreh edhe për partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin konstruktiv. Kontributi i tyre ka qenë i rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale, zhvillimin e jurisprudencës kushtetuese, shkëmbimin e përvojave profesionale me gjykatat kushtetuese homologe dhe avancimin e standardeve të punës në përputhje me praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Duke e konsideruar këtë raport si një dritare komunikimi dhe dialogu me profesionistët e së drejtës, por edhe me publikun e gjerë, rrithej angazhimin tim personal, si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, në garantimin e rendit kushtetues, si dhe të vlerave themelore të demokracisë e të dinjitetit njerëzor.

Gjykata, e vetëdijshme për sfidat që e presin, por me përgjegjësinë e plotë për ta bërë më të sigurt rrugëtimin e Shqipërisë ndaj vlerave evropiane, do të vijojë të mbrojë Kushtetutën dhe të forcojë demokracinë kushtetuese, në mënyrë që të mbahet gjallë preambula e Kushtetutës në lidhje *"... me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ..."*.

Me angazhimin që kjo dritare dialogu e komunikimi do të forcohet në muajt që do të vijnë, shpresoj që 2026-ta të jetë një vit ku drejtësia kushtetuese të bëhet më efektive e më e besueshme dhe Gjykata të kontribuojë në realizimin e qëllimit që hartuesit e Kushtetutës i kanë besuar, atë të Rojës besnike së saj.



Një vit arritje dhe sfida

Viti 2025 përfaqëson një fazë të rëndësishme të konsolidimit të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht në fushën e gjyimit të konflikteve kushtetuese ndërmjet pushteteve, kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, si dhe garantimit efektiv të lirive dhe të drejtave themelore të individit.

Numri i kërkesave të paraqitura pranë Gjykatës, në veçanti i ankimeve kushtetuese individuale, vijoi të shënojë rritje edhe gjatë këtij viti, duke reflektuar njëkohësisht rritjen e besimit të publikut në garancitë e drejtësisë kushtetuese dhe afirmimin në rritje të rolit të Gjykatës si garante e rendit kushtetues dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut.

Gjatë vitit 2025, Gjykata arsyetoi gjithsej 429 vendime, por pavarësisht ngarkesës së konsiderueshme, Gjykata mbeti e angazhuar për respektimin e afateve ligjore të shqyrtimit gjyqësor, duke vendosur theks të veçantë në cilësinë, koherencën dhe qëndrueshmërinë e standardeve kushtetuese.

Zhvillimi dhe konsolidimi i jurisprudencës

Gjykata Kushtetuese vijoi të konsolidojë rolin e saj si garantuese e rendit kushtetues dhe e balancës ndërmjet pushteteve, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Veprimtaria institucionale u orientua drejt përmbushjes së objektivave strategjike për një drejtësi kushtetuese të qëndrueshme dhe me integritet, duke forcuar më tej standardet e funksionimit institucional. Në këtë kuadër, proceset e analizës periodike të punës dhe diskutimet mbi planifikimin strategjik shërbyen si mekanizma reflektimi mbi arritjet

dhe sfidat, duke siguruar vazhdimësi dhe koherencë në politikat institucionale dhe në zhvillimin afatgjatë të Gjykatës.

Zhvillimi dhe konsolidimi i jurisprudencës

Gjykata vijoi përmbushjen e objektivave të saj strategjike, duke intensifikuar përpjekjet për garantimin e një drejtësie kushtetuese funksionale dhe të pavarur. Prioritete të veprimtarisë kanë qenë konsolidimi i standardeve interpretative në respektim të parimeve themelore kushtetuese. Jurisprudenca kushtetuese e vitit 2025 reflekton një orientim të qëndrueshëm drejt forcimit të shtetit të së drejtës, konsolidimit të ndarjes dhe balancës ndërmjet pushteteve dhe garantimit efektiv të të drejtave dhe lirive themelore. Gjykata Kushtetuese, përmes shqyrtimit të ankimeve kushtetuese individuale, ka vijuar të konsolidojë standardet kushtetuese në disa aspekte thelbësore të të drejtave dhe lirive themelore. Disa nga vendimet e spikatura dhe të cilat kanë sjellë risi në praktikën gjyqësore kanë trajtuar lirinë e shprehjes, mbrojtjen e jetës private dhe të të dhënave personale, paprekshmërinë e banesës dhe ambienteve profesionale, të drejtën e pronës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata ka evidentuar rolin e saj si garantuese e ekuilibrit

Për të shkarkuar raportin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Linku i raportit](#) ose skanoni kodin QR.



ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të individit, duke zhvilluar më tej standardet e proporcionalitetit, kontrollit gjyqësor efektiv dhe jo arbitrar, që bie ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, duke përforcuar harmonizimin e jurisprudencës kombëtare me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe duke promovuar rolin e saj si garantuese e efektivitetit të mbrojtjes kushtetuese për individin.

Kontributi në kulturën kushtetuese

Një nga arritjet më të rëndësishme të vitit 2025 ishte vijimi i përpjekjeve për sistematizimin dhe rritjen e aksesueshmërisë së jurisprudencës kushtetuese. Publikimi i “Udhërrëfyesit të Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese – Vëllimi II” përfaqëson një hap të rëndësishëm në këtë drejtim, duke përmbledhur dhe analizuar standardet e zhvilluara nga Gjykata në lidhje me parimet kushtetuese, të drejtat dhe liritë themelore, si dhe ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Ky botim shërben si një instrument referues me vlerë të veçantë praktike dhe akademike për gjyqtarët, avokatët, këshilltarët ligjorë, studiuesit dhe studentët e drejtësisë, duke lehtësuar kërkimin ligjor dhe duke kontribuar në rritjen e koherencës së praktikës kushtetuese. Udhërrëfyesi mbetet një kontribut me vlerë në forcimin e rolit edukues të Gjykatës në zhvillimin e doktrinës kushtetuese dhe të kulturës juridike në vend, duke afruar më tej standardet kombëtare me ato evropiane dhe ndërkombëtare.

Transparenca, aksesueshmëria dhe orientimi drejt qytetarit

Rritja e transparencës institucionale dhe e qasjes së publikut në drejtësinë kushtetuese mbeti një nga prioritetet kryesore të veprimtarisë së Gjykatës gjatë vitit 2025. Gjykata synoi të forcojë rolin e saj si një institucion i hapur, i orientuar drejt qytetarit dhe i ndjeshëm ndaj nevojës për transparencë, përmes nismave konkrete për

rritjen e qasjes së publikut në informacionin dhe praktikën e saj gjyqësore. Përmes publikimit në kohë reale të vendimeve, njoftimeve dhe informacionit mbi seancat plenare në faqen zyrtare, Gjykata vijoi të garantojë informim të qartë dhe të aksesueshëm për publikun dhe profesionistët e së drejtës. Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave publike dhe përdorimi i kanaleve digjitale të komunikimit kontribuan në rritjen e transparencës dhe besimit publik. Në të njëjtën kohë, organizimi i konferencave për shtyp në ditën e shpalljes së dispozitivëve të vendimeve mundësoi një komunikim më të drejtpërdrejtë dhe më të kuptueshëm të vendimmarrjes kushtetuese. Konsolidimi i botimit të buletinit elektronik të vendimmarrjes vijoi edhe gjatë vitit 2025. Ky botim u shndërrua në një instrument të qëndrueshëm informues, duke rritur parashikueshmërinë e praktikës gjyqësore dhe duke lehtësuar njohjen e standardeve kushtetuese.

Modernizimi institucional dhe rritja e eficiencës organizative

Nisur nga rritja e numrit të çështjeve dhe kompleksiteti i tyre, Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2025 vendosi theks të veçantë në modernizimin e proceseve të punës dhe në rritjen e eficiencës organizative. Analizat periodike të veprimtarisë institucionale shërbyen për identifikimin e nevojave operacionale dhe përshtatjen e strukturave të brendshme me kërkesat në rritje të funksionimit të Gjykatës. Në këtë kuadër, u thellua bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për ngritjen e një sistemi bashkëkohor të menaxhimit të çështjeve dhe për digjitalizimin e arkivit, projekt i cili synon të përmirësojë organizimin e brendshëm,

Për të shkarkuar Udhërrëfyesin, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Udhërrëfyesi II](#) ose skanoni kodin QR



efikasitetin dhe transparencën institucionale në vitet në vijim. Gjithashtu, Gjykata i ka kushtuar vëmendje të veçantë edhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të administratës, veçanërisht të Njesisë së Shërbimit Ligjor, si bërthama shkencore juridike që ofron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës. Përballë kompleksitetit në rritje të çështjeve me natyrë kushtetuese dhe kontrollit substancial të të drejtave themelore, Gjykata mbetet e angazhuar për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e aftësive kërkimore dhe analitike, përditësimin e njohurive profesionale të këshilltarëve ligjorë me zhvillimet e jurisprudencës kushtetuese të vendeve të tjera evropiane dhe GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë

Gjatë vitit 2025, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë vijoi të mbetet një nga dimensionet më të rëndësishme të veprimtarisë institucionale të Gjykatës Kushtetuese, duke kontribuar në realizimin e objektivave strategjikë dhe në rritjen e cilësisë së jurisprudencës kushtetuese. Me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Fondacionit Konrad Adenauer, Gjykata finalizoi dhe publikoi Udhërrëfyesin e dytë të jurisprudencës, duke forcuar aksesueshmërinë dhe sistematizimin e praktikës kushtetuese. Në bashkëpunim me Fondacionin IRZ u organizuan vizita studimore dhe seminare profesionale mbi ankimin kushtetues individual, të cilat kontribuan në shkëmbimin e përvojave dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale. Gjithashtu, në partneritet me Këshillin e Evropës filluan përpjekjet për ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit të çështjeve dhe digjitalizimin e arkivit, me synim rritjen e efikasitetit dhe transparencës institucionale. Veprimtaria institucionale e vitit 2025 dëshmon një zhvillim të qëndrueshëm të Gjykatës Kushtetuese, të orientuar drejt forcimit e modernizimit institucional në përputhje me standardet

evropiane të drejtësisë kushtetuese, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Dialogu gjyqësor dhe angazhimi ndërkombëtar

Në planin ndërkombëtar, gjatë vitit 2025, Gjykata Kushtetuese tregoi një angazhim serioz në arenën rajonale dhe ndërkombëtare të drejtësisë kushtetuese, duke ushtruar në mënyrë aktive funksionin e saj si gjykatë kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC) për periudhën 2024–2027. Në kuadër të këtij kryesimi, një moment me rëndësi të veçantë ishte organizimi në Tiranë, më 28 shkurt 2025, i Takimit Përgatitor të Rrethit të Kryetarëve të CECC-së, një nga organet kryesore drejtuese e vendimmarrëse të kësaj Konference. Gjatë këtij takimi u morën vendime kyçe për organizimin e Kongresit të ardhshëm të XX-të të CECC, i cili do të mbahet në Shqipëri në vitin 2027. Një zhvillim me domethënie të veçantë institucionale dhe historike ishte edhe miratimi nga shumica e gjykatave anëtare të CECC i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për anëtarësim me të drejta të plota në këtë organizëm. Një tjetër dimension i rëndësishëm i angazhimit ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese gjatë vitit 2025 ishte pjesëmarrja e saj aktive në kuadër të Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese (WCCJ) dhe të Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone (ACCF). Në tetor 2025, në Madrid, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në cilësinë e Gjykatës kryesuese të CECC-së, drejtoi takimin e grupimit rajonal të CECC-së, i cili i parapriu punimeve të Kongresit të VI-të të Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese, si dhe

Për të vizituar kanalin në YouTube të Gjykatës Kushtetuese ju lutem referojuni lidhjes: [YouTube Gjykata Kushtetuese](#) ose skanoni kodin QR



përfaqësoi gjykatat evropiane në Byronë e kësaj Konference, duke përcjellë qëndrimet dhe prioritetet e tyre mbi çështje me rëndësi globale. Po ashtu, gjatë vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë u zgjodh për herë të parë si anëtare e Byrosë Drejtuese të Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone, gjatë Kongresit të X-të të ACCF-së të mbajtur në Bukuresht, duke forcuar më tej profilin e saj ndërkombëtar dhe duke konfirmuar besimin e komunitetit kushtetues frankofon dhe global në kontributin e saj për promovimin e drejtësisë kushtetuese, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Gjykata mbetet e angazhuar për të çuar më tej dialogun gjyqësor ndërkombëtar si dhe vijimin e shkëmbimit të praktikave të mira me gjykatat homologe, si një burim i çmuar për përmirësimin e standardeve kushtetuese dhe integrimin e vlerave më të mira kushtetuese evropiane.

Sfidat dhe e ardhmja

Pavarësisht zhvillimeve pozitive dhe arritjeve të shënuara gjatë vitit 2025, veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese u shoqërua edhe me një sërë sfidash, të cilat kërkojnë një qasje të kujdesshme, të balancuar dhe profesionalisht të qëndrueshme. Rritja e vazhdueshme e numrit të ankimeve kushtetuese individuale, e shoqëruar me kompleksitetin në rritje të çështjeve që lidhen me konfliktet mes pushteteve, kontrollin e ligjeve dhe mbrojtjen e të drejtave themelore, solli nevojën për angazhim më të madh analitik dhe për përdorimin e metodologjive gjithnjë e më të avancuara të analizës juridike. Kjo dinamikë kërkon jo vetëm burime njerëzore dhe logjistike të përshtatshme, por edhe inovacion në organizimin e punës dhe në mbështetjen kërkimore, në mënyrë që cilësia e vendimmarrjes të mbetet në përputhje me standardet më të larta kushtetuese dhe evropiane.

Po ashtu, zhvillimet e vrullshme shoqërore dhe teknologjike, si dhe evoluimi i standardeve

evropiane në fushën e të drejtave të njeriut, kërkojnë një përditësim të vazhdueshëm të qasjes interpretative dhe një përshtatje të jurisprudencës me sfidat kushtetuese. Kjo lidhet edhe me një sfidë tjetër të rëndësishme, atë të rritjes së pritshmërive nga aktorë të ndryshëm institucionalë dhe, në mënyrë të veçantë, nga publiku, për vendimmarrje të shpejtë dhe efektive në çështje që shpesh kanë ndikim të drejtpërdrejtë social, ekonomik apo politik. Në një kontekst të tillë, Gjykata është përballur me nevojën për të ruajtur një ekuilibër të qëndrueshëm ndërmjet kërkesës për efikasitet dhe detyrimit për një shqyrtim të thelluar dhe të paanshëm, duke shmangur çdo perceptim të ndikimit të jashtëm mbi procesin vendimmarrës.

Përballë këtyre sfidave, Gjykata Kushtetuese mbetet e vetëdijshme se ruajtja e autoritetit kushtetues dhe e besimit publik kërkon vetëpërmbytje institucionale, maturi në komunikim dhe qëndrueshmëri në jurisprudencë. Për këto arsye, angazhimet për vitin 2026 synojnë konsolidimin e mëtejshëm të rolit të Gjykatës Kushtetuese si garantuese e kushtetutshmërisë, forcimin e besimit të publikut dhe përshtatjen e vazhdueshme të veprimtarisë së saj me sfidat e reja institucionale dhe shoqërore.

Për të ndjekur angazhimet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare të Gjykatës Kushtetuese ju lutem referojuni lidhjes: [Takime zyrtare jashtë vendit](#) ose skanoni kodin QR





REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE

2025 në shifra

501

Kërkesa të regjistruara
Rritje prej **17%** nga **2024**

429

vendime të arsyetuara
71% përkundrejt numrit të kërkesave

85

vendime përfundimtare
ose **20%** e vendimmarrjes

316

vendime moskalimi të Kolegjeve
ose **74%** e vendimmarrjes

28

vendime moskalimi të Mbledhjes së Gjyqtarëve
ose **6%** e vendimmarrjes

Për të shkarkuar të dhëna
statistikore për vitin 2025, ju lutem
referojuni faqes së internetit të
Gjykatës Kushtetuese: [Të dhëna
Statistikore](#) ose skanoni kodin QR



8
muaj

Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve për
vendimet përfundimtare

3
muaj

Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve për
vendimet e moskalimit

Gjykata ka respektuar afatet procedurale të kërkesave, në përputhje me parashikimet e ligjit organik të Gjykatës, si dhe me Rregulloren për Procedurat Gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.

Asnjë çështje nuk është e tejzgjatur apo e prapambetur.

Vlen të theksohet gjithashtu fakti që në Gjykatë nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë kërkesë për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese.

Shërbimet ndaj publikut



www.gjykatakushtetuese.gov.al

Vizita **22,892**

Përshtypje **146,290**

Youtube

Vizita **56,244**

Përshtypje **354,786**

Të abonuar **413**

Koha në ndjekje **11,289**
(orë gjithsej)



Facebook

Vizita **47,200**

Ndjekës **898**

Ndërveprimi **1,100**



Linkedin

Përshtypje **129,818**

Ndjekës **3,904**

Ndërveprimi **2,489**



X

Përshtypje **423**

Ndjekës **136**

Ndërveprimi **22**



Publikime

6 buletine periodike

1 udhërrëfyes

27 komunikime për shtyp

Për të shkarkuar publikimet për vitin
2025, ju lutem referojuni faqes së
internetit të Gjykatës Kushtetuese:
[Publikime](#) ose skanoni kodin QR





Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.



Nëntor 2025

Emërohet një gjyqtar i ri




Dhjetor 2025

Zgjidhet njëzëri Kryetari i ri

Gjatë vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ushtrroi funksionet e saj me 8 gjyqtarë kushtetues, pra me një përbërje jo të plotë në raport me numrin prej nëntë anëtarësh të parashikuar nga Kushtetuta.

Megjithatë, Gjykata arriti të sigurojë vijimësinë e funksionimit institucional dhe ushtrimin efektiv të kompetencave të saj kushtetuese, duke garantuar zhvillimin e procesit vendimmarrës dhe shqyrtimin e çështjeve me rëndësi kushtetuese.






Për jetëshkrimin e anëtarëve të
Gjykatës Kushtetuese ju lutem
referojuni faqes së internetit në lidhjen:
[Përbërja – Gjykata Kushtetuese](#) ose
skanoni kodin QR





Dr. Fiona Papajorgji,
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë, në nëntor 2019



Marsida Xhaferllari,
Anëtare
Emëruar nga Presidenti i Republikës,
në nëntor 2019



Sonila Bejtja,
Anëtare
Emëruar nga Presidenti i Republikës,
në dhjetor 2020



Dr. Sandër Beci,
Anëtar
Emëruar nga Gjykata e Lartë,
në mars 2022



Ilir Toska,
Anëtar
Emëruar nga Gjykata e Lartë,
në shtator 2022



Gent Ibrahimi,
Anëtar
Emëruar nga Presidenti i
Republikës, në dhjetor 2022



Prof. Dr. Marjana Semini,
Anëtare
Emëruar nga Kuvendi i
Shqipërisë, në dhjetor 2022



Dr. Asim Vokshi,
Anëtar
Emëruar nga Gjykata e Lartë,
në nëntor 2025

Struktura organizative dhe buxheti


Struktura organizative e miratuar ka gjithsej **88** punonjës




Sekretar
i përgjithshëm



Kabineti



Njësia
e Shërbimit Ligjor



Drejtoria
Gjyqësore dhe
e Dokumentacionit



Zyra e Auditit
të Brendshëm



Drejtoria
Shërbimeve Juridike,
Prokurimeve
dhe Teknologjisë
së Informacionit



Drejtoria
e Marrëdhënieve
me Publikun
dhe me Jashtë



Drejtoria Ekonomike,
Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve
Mbështetëse




Drejtoria
e Kërkimeve,
Studimeve
dhe Botimeve

Në vitin **2025** ka qenë e plotësuar **81%** e strukturës



71 punonjës me kohë të plotë



■ Gra ■ Burra



Buxheti i akorduar gjatë vitit **2025** është

264,032,336 lekë

ose **14% më pak** se ai i vitit **2024**

Jurisprudenca kushtetuese në fokus

ÇËSHTJE TË PËRZGJEDHURA



Kontrolli i pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën

Liria për të ushtruar profesionin e mjekut

 Vendimi nr. 58, datë 15.10.2025

 Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë

Autonomia dhe pavarësia e Urdhrit të Mjekëve nuk përjashton ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse të shtetit në fushat ku realizohet një interes publik.

Vetë balanca midis interesit publik për garantimin e standardeve më të larta shëndetësore dhe së drejtës individuale për të ushtruar profesionin ruhet përmes respektimit të detyrimeve të mjekut ndaj institucionit publik dhe rregullave mbi konfliktin e interesit, pa pasur nevojë për një autorizim paraprak nga titullari.

Çdo ndërhyrje që prek ushtrimin e së drejtës për të ushtruar profesionin duhet të bazohet në norma të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme, në mënyrë që individi (mjeku në rastin konkret) të mund të dijë paraprakisht pasojat disiplinore të veprimeve ose mosveprimeve të tij.

Faktet

Kuvendi miratoi ligjin nr. 123, datë 25.09.2014, *“Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”*, dhe më pas Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 2/2024, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”*. Kuvendi me ligjin nr. 94/2024, miratoi aktin normativ me fuqinë e ligjit. Shtesat dhe ndryshimet lidheshin me kompetencat e Urdhrit të Mjekëve, kriteret dhe ndërprerjen e anëtarësisë, detyrimet e anëtarëve të këtij urdhri, kushtet e ushtrimit të profesionit, organet e Urdhrit të Mjekëve, përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar, funksionet

e këshillave rajonale, komisionet disiplinore, masat disiplinore dhe ankimin gjyqësor, si dhe kompetencën e Këshillit Kombëtar për Kodin e Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore. Me vendimin nr. 85, datë 05.02.2025, të Këshillit të Ministrave *“Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit”* u përcaktuan rregullat për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit, kryerjen e një procesi të rregullt ligjor për shqyrtimin e pretendimeve për shkelje disiplinore dhe zbatimin e masave disiplinore që zbatoheshin për mjekët që ushtrojnë profesionin në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike në Republikën e Shqipërisë. Sindikata iu drejtua Gjykatës për shfuqizimin e aktit normativ ose në alternativë shfuqizimin e disa neneve të tij, ose deklarin e ometimit ligjor të mundësisë së mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, si dhe trajtimin me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike. Kërkuesi tjetër, Urdhri i Mjekëve, iu drejtua Gjykatës për shfuqizimin e aktit normativ dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave. Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi bashkimin e çështjeve në një të vetme.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimi i shtetit të së drejtës – Urdhri i Mjekëve ndonëse është një person juridik i së drejtës publike i krijuar me ligj, ushtron kompetenca që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e objektivave sociale të shtetit në fushën e shëndetësisë çka do të thotë se, ai ushtron funksione të një natyre publike, prandaj edhe ndaj tij duhet të garantohet një sistem vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje. Gjykata çmon se, përfshirja e ministrisë përkatëse në organizimin dhe funksionimin e komisioneve të disiplinës të Urdhrit të Mjekëve, si dhe në

procesin e miratimit të Kodit të Etikës, përbën një masë të arsyeshme dhe proporcionalisht të justifikuar të mbikëqyrjes shtetërore, ndërhyrje kjo që gjen mbështetje në natyrën publike të funksionit që ushtron Urdhri i Mjekëve. Kjo pjesëmarrje nuk cenon pavarësinë funksionale të Urdhrit të Mjekëve, por synon të krijojë një ekuilibër ndërmjet autonomisë profesionale dhe përgjegjësisë publike në mbrojtje të interesit publik. Gjykata arrin në përfundimin se, organizimi i miratuar nga akti normativ objekt kundërshtimi nuk përbën ndërhyrje të pajustificuar në autonominë e Urdhrit të Mjekëve, por është një mekanizëm kontrolli që i shërben zbatimit të detyrimeve kushtetuese të shtetit në mbrojtje të sigurimit të standardeve të larta shëndetësore. Gjykata vlerëson se, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës është i pabazuar.

Liria e veprimtarisë ekonomike e lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit

Për kufizimin e 30% të orëve mujore – Gjykata, në lidhje me këtë pretendimin të kërkuarve, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje dhe pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike për shkak të kufizimit 30% konsiderohet i rrëzuar.

Për detyrimin për t'i bërë kërkesë titullarit për të ushtruar profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik – Gjykata thekson se, për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë në një institucion shëndetësor jopublik nuk pengon kryerjen e detyrave në institucionin publik dhe nuk krijon konflikt interesi, nuk ekziston ndonjë arsye kushtetuese që ta kushtëzojë këtë me dhënien e një lejeje administrative. Mungesa e detyrimit për arsyetimin e vendimit dhe pamundësia e një mjeti efektiv ankimi e bën këtë kompetencë të titullarit diskrecionale dhe nuk ofron garancitë e nevojshme procedurale. Gjykata çmon se, kufizimi që vendos ky nen nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit ndërmjet qëllimit publik të garantimit të standardeve më të larta shëndetësore dhe ushtrimit të lirë të profesionit nga mjekët. Nga njëra anë, ligji njeh mundësinë e dypunësimit të mjekëve dhe nga ana tjetër i jep titullarit një kompetencë vendimmarrëse

që praktikisht e bën këtë të drejtë të pamundur për t'u realizuar. Detyrimi për të marrë leje nga titullari, është i tillë që, në praktikë, mund të çojë në mohimin e plotë të së drejtës për të ushtruar profesionin në sektorin shëndetësor jopublik, duke e bërë kufizimin joproporcional në raport me qëllimin e ndjekur. Gjykata vlerëson se, pretendimi i kërkuarve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i bazuar.

Për cenimin e së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni të lidhur me parimin e proporcionalitetit – Gjykata vlerëson se, dispozita në fjalë nuk përmbush standardin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë së ligjit. Dispozita e ndryshuar e nenit 17, të ligjit nr. 123/2014, në pjesën që parashikon aplikimin e masës disiplinore, heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nuk plotëson standardin kushtetues të qartësisë dhe të parashikueshmërisë. Parashikimi në aktin normativ i masës disiplinore të heqjes së licencës në mënyrë të përhershme dhe pa përcaktuar kriteret e qarta, për të cilat kjo masë mund të jepet, shkon përtej karakterit të dënimit penal dhe për këtë arsye cenon në thelb të drejtën për punë dhe ushtrimin e një profesioni. Pretendimi i kërkuarve në këtë drejtim është i bazuar, prandaj Gjykata vlerëson se, shkronja "d", e pikës 1, të nenit 17, dhe fjalia e fundit e pikës 3, të po këtij neni, ndryshuar me nenin 10, të aktit normativ duhet të shfuqizohen.

Për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës – Lidhur me këtë pretendim për cenimin e nenit 101, të Kushtetutës, për shkak të miratimit të aktit normativ në mungesë të kushteve të nevojës dhe urgjencës, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje dhe pretendimi u konsiderua i rrëzuar.

Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



KONFLIKTI I KOMPETENCAVE MES PUSHTETEVE

Konflikti i kompetencave mes 1/10 -ës së deputetëve dhe Kuvendit

 Vendimi nr. 35, datë 27.05.2025

 Jo më pak se një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit

Kryetari i Kuvendit ose 1/10-ta e deputetëve janë subjektet që vënë në lëvizje Kuvendin me mocionin për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, ndërsa Kuvendi është subjekti që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Në rast të rrëzimit të këtij mocioni, aktivizohet e drejta e 1/5-ës së deputetëve për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për shqyrtimin në themel të çështjes.

Kërkesa nuk përbën një mosmarrëveshje kompetencash në kuptim të standardeve kushtetuese, por është shtruar si një konflikt që lidhet me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit.

Faktet

14 deputetë të Partisë Demokratike paraqitën një mocion në Kuvend për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetit Vullnet Sinaj dhe dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese. Sipas tyre gjatë ushtrimit të mandatit në periudhën 2017–2024, ky deputet, përmes shoqërive të tij, ka përfituar të ardhura nga buxheti i shtetit në kundërshtim me nenin 70, pika 3, të Kushtetutës. Kuvendi vendosi mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit të jo më pak se 1/10-ës së deputetëve. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës mes tij dhe Kuvendit dhe shfuqizimin e vendimit të këtij të fundit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për juridiksionin e Gjykatës

Kur Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të 1/10-ës të deputetëve ose Kryetarit të tij, ka detyrimin kushtetues për të filluar procedurën parlamentare për shqyrtimin e mocionit për dërgimin e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit në Gjykatë. Në rast të rrëzimit të mocionit, në kuptim të bërjes efektiv të mekanizmit të kontrollit kushtetues të parashikuar nga shkronja “e”, e pikës 1, të nenit 131 të Kushtetutës, paraqitja e kërkesës nga jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, në kuptim të së drejtës së saj sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, të reflektuar në pikën 2, të nenit 66 të ligjit nr. 8577/2000, përbën mjetin alternativ për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues për kontrollin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit.

Në rastin në shqyrtim pavarësisht se, në objekt të kërkesës është kërkuar zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave midis kërkuesit dhe Kuvendit, në thelb ajo çka synohet është papajtueshmëria e mandatit të deputetit, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës. Ndaj kërkuesit, 1/10-ta e deputetëve, i mungon legjitimiteti për të vënë drejtpërdrejt në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje kushtetuese, pra për konstatimin e deklarimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj.

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës.

 Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



KONFLIKTI I KOMPETENCAVE MES PUSHTETEVE

Kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit kushtetues dhe përtëritja e rregullt e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese

 Vendimi nr. 60, datë 16.10.2025

 Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë, parimi i pavarësisë nënkupton gjithashtu se, gjyqtari në momentin e emërimit duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë.

Gjykata thekson se parimi i përtëritjes të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese mbizotëron mbi atë të patundshmërisë në detyrë të gjyqtarit.

Faktet

Vendimi nr. 62/2024, i Gjykatës Kushtetuese, deklaroi mbarimin e mandatit të gjyqtarës kushtetuese E.T. përpara afatit, për shkak të dorëheqjes së saj, por nuk caktoi datën e mbarimit të këtij mandati kushtetues. Në vijim Kuvendi, si organi i emërtesës së gjyqtarës kushtetuese, njoftoi hapjen e procedurës për plotësimin e kësaj vakance duke konsideruar se gjyqtarja E.T. ishte emëruar në datën 14.11.2019, për një mandat të plotë 9-vjeçar dhe përcaktoi datën 14.11.2028, si datë të mbarimit të mandatit plotësues.

Në lidhje me mandatin e gjyqtarës kushtetuese H.Z., organi tjetër i emërtesës, Gjykata e Lartë, nëpërmjet Kryetarit të saj, në datën 11.12.2024, njoftoi hapjen e procedurës për zgjedhjen e gjyqtarit të ri pasues nga ky organ. Në vijim

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese iu drejtua Gjykatës me kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit të saj si gjyqtare. Gjykata, me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, deklaroi mbarimin e mandatit të gjyqtarës H.Z. në datën 10.03.2025, për shkak të përfundimit të afatit të kohëzgjatjes së tij. Vendimi përcaktoi gjithashtu se, shpallja e vakancës nga organi i emërtesës bëhet pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Pasi u njoh me këtë vendim Presidenti, në cilësinë e njërit prej tre organeve të emërtesës, në datën 30.01.2025, iu drejtua Gjykatës me kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, që i përket emërtesës së tij.

Vlerësimi i Gjykatës

Mbi deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues – Gjykata vëren se, kërkesa e Presidentit ka si objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, por baza ligjore dhe shkaqet në përmbajtje të saj kanë të bëjnë me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash e në funksion të kësaj, interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 miratuan dispozitën kalimtare, nenin 179, pikën 3, që parashikon: *“Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit.”* Gjykata vlerëson se, për sa kohë ligjvënësi kushtetues në përmbushje të jurisprudencës kushtetuese përcaktoi mekanizmin e vlefshëm dhe të përshtatshëm për respektimin e parashikimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të saj, një interpretim i ndryshëm i nenit 179, pika 3,

të Kushtetutës, qoftë edhe duke kërkuar përsëri ndërhyrjen e ligjvënësit kushtetues, do të binte ndesh me parimin e luajalitetit kushtetues dhe atij të koherencës së jurisprudencës së Gjykatës, të cilave i nënshtrohet edhe vetë Gjykata.

Gjykata thekson se, kohëzgjatja e mandateve kushtetuese që i përkasin këtij regjimi tranzitor ka qenë e kufizuar në kohë, pasi vetëm në këtë mënyrë dhe vetëm përmes këtij interpretimi do të garantohet qëllimi kryesor i dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Parashikimi i shprehur në këtë dispozitë për përcaktimin e dy mandateve më të shkurtra se 9 vjet, i shërben dhe është në funksion të garantimit të parimit të përtëritjes së rregullt, i cili ka kuptimin të vendosë rregullin e përtëritjes me një të tretën dhe jo anasjelltas.

Neni 179, pika 3, i Kushtetutës, në ndryshim nga neni 125, pika 7, i saj, që parashikon se gjyqtari kushtetues vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, nuk flet për gjyqtarë pasardhës, por për gjyqtarin që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017. Për rrjedhojë, norma kushtetuese (dispozita kalimtare) përmban një parashikim të ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm i kohëqëndrimit në detyrë dhe mbarimit të mandatit. Në funksion të zbatimit të parimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës, nga kushtetutëbërësi duket se është pasur në konsideratë lidhja mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit (ideal) të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri.

Edhe pse skema për përtëritjen e përbërjes së Gjykatës përgjatë regjimit tranzitor parashikon mundësinë që gjyqtari kushtetues të ushtrojë detyrën për një kohëzgjatje më të shkurtër se mandati kushtetues 9-vjeçar, kjo gjen mbështetje kushtetuese dhe është e lejueshme nga vetë kushtetutëbërësi, për sa kohë reflekton vetë konceptin e tij kushtetues, me qëllim garantimin e parimit të përtëritjes periodike të pjesshme të kësaj Gjykate. Ky lloj kuptimi nuk e shfuqizon afatin 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës, por e lidh zbatimin e tij si një proces gjithëpërfshirës me periudhat e përtëritjes të Gjykatës. Në vlerësimin e Gjykatës, respektimi i këtij parimi do të garantonte edhe respektimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve përmes respektimit të mekanizmit kushtetues të kuotave

të secilit organ emërtese në përbërjen e Gjykatës çdo tre vjet.

Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se mandati i gjyqtarit kushtetues, emërtesë e Presidentit të Republikës ka përfunduar në datën 25.04.2025, datë e cila përkon me datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që e zëvendëson. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se, në përputhje me interpretimin e vendimit të saj, mandati kushtetues që është emërtesë e Kuvendit ka mbaruar po në datën 25.04.2025. Prandaj Kuvendi duhet të marrë masat për të garantuar respektimin e përtëritjes së pjesshme të Gjykatës në vitin 2025, duke rishpallur procedurat për zgjedhjen e gjyqtarit të ri kushtetues, pjesë e kuotës së tij, në përputhje me parashikimet kushtetuese e ligjore në fuqi, si dhe me arsyetimin e këtij vendimi.

Gjykata vendosi mbi kompetencën për deklarimin e mandatit; shqyrtimin veçmas për deklarimin e mbarimit të mandatit; interpretimin e nenit 179/3 të Kushtetutës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



QEVERISJA VENDORE

E drejta për proces të rregullt ligjor në procedurën e shkarkimit nga detyra të Kryetarit të Bashkisë

 Vendimi nr. 66, datë 03.11.2025

 Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

Shkarkimi i kryetarit të bashkisë bëhet vetëm në rast se ai ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës ose ligjeve. Ligjvënësi i zakonshëm nuk ka kompetencën për të parashikuar shkaqe të tjera ose më të gjera shkarkimi përtej shkeljes së rëndë kushtetuese ose ligjore. Masa e shkarkimit sjell pasoja të drejtpërdrejta në ushtrimin e mandatit të zgjedhur, ndaj organet publike kanë detyrimin pozitiv të sigurojnë aktivisht respektimin e të drejtave procedurale të organit të shkarkuar dhe të shmangin çdo praktikë që privon mundësinë reale të mbrojtjes.

Faktet

Ndaj kërkuesit, kryetar i zgjedhur i Bashkisë Tiranë në vitin 2025, u vendos nga gjykatat masa e sigurimit “arrest në burg” për efekte të procedimit penal të nisur ndaj tij në vitin 2024. Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 69, datë 23.09.2025, i propozoi Këshillit të Ministrave shkarkimin nga detyra të kërkuesit, bazuar në nenin 62, shkronja “c”, të Ligjit për Qeverisjen Vendore, sipas të cilit kryetari i bashkisë shkarkohet për mosparaqitje në detyrë për një periudhë tremujore të pandërprerë, duke mos i atribuuar atij ndonjë sjellje të kryer me faj. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 539, datë 25.09.2025, vendosi shkarkimin nga detyra të kërkuesit. E gjithë procedura administrative për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë zgjati vetëm 5 ditë. Lidhur me këtë procedurë kërkuesi nuk u njoftua për t’u dëgjuar

dhe as nuk iu njoftuan aktet respektive. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual ku kërkoi shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave.

Mbi njoftimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e vakancave për kryetarë në gjashtë bashki të vendit, përfshirë edhe Bashkinë e Tiranës dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme, Presidenti dekretoi në datën 01.10.2025, datën e zgjedhjeve edhe për Bashkinë Tiranë. Kërkuesi iu drejtua sërish Gjykatës, duke kërkuar edhe shfuqizimin e dekretit për caktimin e zgjedhjeve dhe pezullimin e efekteve të tij për pjesën që caktonte datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Tiranë. Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pezullimin e dekretit për pjesën që përcaktonte datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës.

Vlerësimi i Gjykatës

Për juridiksionin kushtetues – Gjykata ka kompetencën për të kontrolluar vendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit të qeverisjes vendore, pavarësisht shkakut të referuar në atë vendim. Formula e shkarkimit të kryetarit të bashkisë nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rëndë kushtetuese dhe ligjore, e parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, përbën mbikëqyrje administrative të pushtetit qendror ndaj veprimtarisë së pushtetit vendor. Ankimi kushtetues i kryetarit të bashkisë ndaj vendimit të shkarkimit është mekanizëm thelbësor mbrojtës i autonomisë vendore dhe balancimit të pushteteve. Ligji nuk ka epërsi ndaj Kushtetutës, ndaj nuk mund të krijojë shkaqe të reja të shkarkimit, përtej parashikimit kushtetues. Gjykata ka kompetencën të kontrollojë edhe dekretin e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve, për shkak të lidhjes funksionale që ai ka me vendimin e shkarkimit të organit të zgjedhur vendor. Këto dy akte nuk janë normative, por janë të njëpasnjëshme në procedurën e zgjedhjes së organit të ri vendor në vendin vakant të krijuar nga shkarkimi dhe i shërbejnë të njëjtit

qëllim kushtetues, ndaj kontrolli i tyre nuk mund të ndahet. E kundërta do të dëmtonte vërtetimin e fakteve të mosmarrëveshjes dhe rrezikonte koherencën e akteve juridike.

Për të drejtën për proces të rregullt ligjor të shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë – Gjykata vlerësoi se, vendimi i shkarkimit të kërkuesit nga detyra është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, i zhvilluar nga këshilli bashkiak dhe Këshilli i Ministrave, që ka sjellë si pasojë cenimin edhe të parimit të autonomisë vendore. Organi publik ka detyrimin pozitiv për të ndërmarrë aktivisht të gjitha masat e domosdoshme procedurale për të garantuar një proces të drejtë. Mosnjoftimi i kërkuesit për arsyet, bazën ligjore dhe ecurinë e procedurës, si dhe mosmarrja e masave të nevojshme për t'i mundësuar atij ushtrimin efektiv të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, krijuan një situatë në të cilën pjesëmarrja e tij u bë iluzore dhe formaliste. Prandaj vendimi për shkarkimin e organit të zgjedhur vendor është marrë duke cenuar thelbin e garancive kushtetuese deri në asgjësimin e tyre.

Përmbajtja eksplicite e nenit 115 të Kushtetutës për shkaqet e shkarkimit nuk i jep ligjvënësit të zakonshëm kompetencën për të parashikuar shkaqe të tjera ose më të gjera shkarkimi përtej shkeljes së rëndë kushtetuese ose ligjore. Ndonëse, ligjvënësi nuk ka përcaktuar se mungesa tremujore e parashikuar në nenin 62, shkronja "c", të Ligjit për Qeverisjen Vendore duhet të jetë e pajustificuar, e qëllimshme ose e varur nga vullneti i organit të qeverisjes vendore, kjo dispozitë nuk mund të interpretohet në mënyrë të shkëputur nga neni 115 i Kushtetutës. Çdo interpretim i nenit 62 të ligjit për qeverisjen vendore duhet të garantojë që zbatimi i tij të mos lejojë që rrethana faktike që nuk burojnë nga sjellja e vet kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të konsiderohen automatikisht shkelje e rëndë e Kushtetutës ose e ligjeve. Mosparaqitja në detyrë për një periudhë të pandërprerë tre-mujore mund të përbëjë shkelje të rëndë në ushtrimin e detyrës nga kryetari i bashkisë, por gjithnjë kur ai mund dhe duhet të mbajë përgjegjësi, në ndryshim nga rasti konkret, ku kërkuesit nuk i atribuohet asnjë lloj përgjegjësie juridike. Zbatimi mekanik i një dispozite ligjore pa u lidhur me kriterin material kushtetues, përbën

shmangie nga rendi kushtetues dhe cenon garancitë thelbësore të ushtrimit të mandatit të përfaqësimit vendor.

Për dekretin e caktimit të zgjedhjeve – Gjykata evidentoi se, Presidenti ka nxjerrë dekretin, edhe pse vendimi i shkarkimit të Këshillit të Ministrave, për shkak të paraqitjes së ankimit kushtetues nga ana e organit të zgjedhur vendor, ishte i pezulluar *ipso iure* sipas nenit 115 të Kushtetutës. Ai ishte i detyruar të priste vendimin përfundimtar të Gjykatës dhe vetëm në rast të lënies në fuqi të vendimit për shkarkimin nga detyra, mund të ushtronte kompetencën e tij. Kompetenca në fjalë duhet të ushtrohet sipas parimit të luajalitetit kushtetues. Ajo synon t'i japë legjitimitetin e nevojshëm demokratik zgjedhjeve të parakohshme që do të zhvillohen, në kuptim të rolit neutral kushtetues të Presidentit, jo vetëm për të përfaqësuar unitetin e popullit dhe për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm, por edhe për të garantuar procesin e rregullt dhe parimin e autonomisë vendore. Në përfundim, Gjykata vlerësoi se, dekreti i Presidentit, për pjesën që ka caktuar datën e zgjedhjeve në bashkinë Tiranë, ka dalë në shkelje të parashikimeve kushtetuese dhe duhet të shfuqizohet.

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta substanciale

Sekuestro preventive “për ekuivalencë” e pasurive

 Vendimi nr. 20, datë 11.04.2025

 Arben Ahmetaj

Për të respektuar kriteret kushtetuese të kufizimit me ligj dhe standardet e gjykimit të drejtë, prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sekuestros dhe gjykatat e zakonshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e saj, duhet të specifikojnë dhe saktësojnë se në cilën prej kategorive sipas nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe nenit 36 të Kodit Penal (KP) përfshihet secili prej sendeve që kërkohet të sekuestrohet, pra nëse bëhet fjalë për sende ose produkte të veprës penale (sekuestro e drejtpërdrejtë) apo për sekuestrim “për ekuivalencë” të sendeve të tjera që nuk hyjnë në kategorinë e atyre që lidhen drejtpërdrejt me veprën penale.

Në ato raste kur është e zbatueshme sekuestro “për ekuivalencë” gjyqtari duhet të arsyetojë në mënyrë të përshtatshme pamundësinë e arritjes së të njëjtit rezultat me një ndërhyrje më pak kufizuese, si për sa i përket shtrirjes së saj në sendet dhe pasuritë që do të preken, ashtu edhe në tagrat e vetë së drejtës substanciale të pronës private.

Mënyra se si gjykatat kanë vlerësuar kërkesën për caktimin e masës së sekuestros dhe kanë zbatuar parashikimet e shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 36, të KP-së, ka sjellë një rezultat arbitrar në të drejtën kushtetuese të pronës private të kërkuesit.

Faktet

Kërkuesi ka marrë cilësinë e personit nën hetim si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 257/a, paragrafi i dytë e 25, 260 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Në kuadër të procedimit penal prokuroria ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për disa pasuri të kërkuesit, mes të cilave një apartament dhe shumat e gjetura në llogarinë dhe depozitën e tij bankare. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur pranimin e kërkesës.

Kërkuesi ka paraqitur ankim për kundërshtimin e vendimit vetëm për sa i përket pasurive të sipërcituara. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka miratuar vendimin e shkallës së parë, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural - Sekuestro preventive mund të urdhërohet jo vetëm mbi sendet që kanë një lidhje specifike me faktin penal që ndiqet penalisht, por edhe “për ekuivalencë”, pra edhe mbi çdo pasuri tjetër vlere e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Për të respektuar kriteret kushtetuese të kufizimit me ligj dhe standardet e gjykimit të drejtë, prokuroria dhe gjykatat e zakonshme duhet të specifikojnë dhe saktësojnë se në cilën prej kategorive sipas nenit 274, të KPP-së, dhe nenit 36, të KP-së, përfshihet secili prej sendeve që kërkohet të sekuestrohet, pra nëse bëhet fjalë për sende ose produkte të veprës penale (sekuestro e drejtpërdrejtë) apo për sekuestrim “për ekuivalencë” të sendeve që lidhen drejtpërdrejt me veprën penale. Sekuestro

“për ekuivalencë”, në ndryshim nga sekuestro e drejtpërdrejtë, duke mos qenë e identifikueshme për shkak të lidhjes me vetë veprën, kërkon zbatimin e disa filtrave. Zbatimi i sekuestros së drejtpërdrejtë mbi vetë produktet e veprës penale apo të ardhurat e saj nuk lejon edhe zbatimin në të njëjtën kohë dhe paralelisht, pra për të njëjtin qëllim, edhe të sekuestros “për ekuivalencë” të pasurive të tjera të individit subjekt i procedimit penal.

Gjykata konstaton se, në vendimet gjyqësore ka kontradikta mes fakteve penale dhe gjetjeve të Prokurorisë së Posaçme dhe konkluzioneve për mënyrën e zbatimit të nenit 36, pika 1, shkronja “ç”, të KP-së, që është baza ligjore e përdorur për sekuestrimin e të tria pasurive objekt ankimi.

Kontradikta e parë ekziston në faktin se, gjykatat kanë vënë në dyshim vetë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë “apartament” ashtu edhe të shumave të sekuestruara. Këto dyshime, duke i konsideruar si produkte të veprës penale, pasi rrjedhin drejtpërdrejt nga këto të fundit, sjellin zbatimin e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 36, të KP-së, sa kohë që sekuestro “për ekuivalencë” është e zbatueshme për ato sende që nuk janë produkt i veprës penale ose që nuk janë objekt hetimi.

Kontradikta e dytë ka të bëjë me faktin se, për të njëjtin *quantum* të dyshuar të përftuar përmes veprimeve të paligjshme gjykatat kanë vendosur masën e sekuestros “për ekuivalencë” si mbi sendin e paluajtshëm “apartament”, ashtu edhe mbi shumat monetare, por pa analizuar se sa dhe në çfarë mase vlera e sendeve të sekuestruara u korrespondon atyre të veprave penale në kuptim të nenit 274, të KPP-së, dhe nenit 36, pika 1, shkronja “ç”, të KP-së.

Prokuroria dhe gjykatat nuk kanë verifikuar mënyrën dhe masën në të cilën vlera e pasurisë “apartament” i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Edhe në kërkesën për vendosjen e sekuestros janë përcaktuar shumat e dyshuara të përfituara në mënyrë të paligjshme, nuk është bërë asnjë vlerësim për raportin mes vlerës së sendit dhe të produkteve të veprave penale. Gjykatat nuk kanë arsyetuar se, përse një kufizim i tillë i tagrave të pronësisë të kërkuarit ishte mjeti i vetëm për të siguruar

qëllimin e synuar dhe se nuk kishte asnjë mjet tjetër, në kuptim të parimit të proporcionalitetit, që të arrinte një rezultat më pak të dëmshëm në të drejtën kushtetuese të pronës private. Mënyra se si gjykatat kanë vlerësuar kërkesën për caktimin e masës së sekuestros dhe kanë zbatuar parashikimet e shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 36, të KP-së, ka sjellë një rezultat arbitrar në të drejtën kushtetuese të pronës private të kërkuarit.

Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta substanciale

Cenimi i lirisë së shprehjes në drejtim të mbrojtjes së burimit të informacionit të një gazetari

 Vendimi nr. 21, datë 22.04.2025

 Elton Qyno

E drejta e gazetarit për të ruajtur burimin e informacionit dhe për të mos e zbuluar atë është një nga kushtet e lirisë së shtypit. Kjo e drejtë nuk është thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë së burimeve, pasi, në thelb, ajo mbron edhe të drejtën e informimit të qytetarëve që është në vetvete interes publik. Kjo e drejtë mund të kufizohet sipas kriterëve kushtetuese por pa asgjësuar thelbin e lirisë së shtypit. Kufizimi mund të justifikohet vetëm nëse nuk ekzistojnë mjete alternative për të arritur të njëjtin qëllim, pra që identifikimi i burimit është mjeti i vetëm ose i fundit, në kuptimin që të gjitha mjetet e tjera të mundshme janë shteruar dhe se interesi legjitim për zbulimin e burimit të informacionit është më i rëndësishëm se sa interesi publik për ruajtjen e konfidencialitetit. Gjykatat e zakonshme duhet të dallojnë rastin kur prokuroria po zhvillon hetime që lidhen me një sjellje të supozuar penale të gazetarit nga rasti i hetimeve të cilat kanë si qëllim kryesor marrjen e informacionit lidhur me burimin e gazetarit dhe vetë gazetari nuk ka kryer ndonjë vepër penale. Ligjvënësi duhet të shohë nevojën e ndryshimit të rregullave ligjore që lidhen me procedurën e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, të cilat duhet t'u përgjigjen si duhet zhvillimeve aktuale të teknologjisë së informacionit, nevojës për hetime efektive, por mbi të gjitha mbrojtjes efektive të lirive themelore të individit.

Faktet

Kërkuesi, në cilësinë e gazetarit, ka publikuar disa artikuj të cilat përmbanin të dhëna sekrete hetimore të një procedimi penal, konkretisht komunikime të një bashkëpunëtori të drejtësisë me persona të tjerë të përfshirë në veprimtari kriminale. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal për veprat penale të zbulimit të akteve dhe të dhënave sekrete dhe ndalimit të dhënies dhe shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin. Kërkuesi është thirrur në prokurori për të identifikuar burimin e informacionit si dhe është paralajmëruar për të mos publikuar në vazhdim materiale që i përkisnin hetimit. Në kushtet kur ai ka refuzuar zbulimin e burimit të informacionit, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar me tre kërkesa gjykatës për lejimin e kontrollit personal, në banesë dhe në vendin e punës, të cilat janë miratuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Po kështu, Prokuroria e Posaçme ka sekuestruar me vendim edhe dy aparatet telefonike të kërkuesit. Në ekzekutim të vendimeve gjyqësore atij i janë sekuestruar sende dhe të dhënat kompjuterike. Kërkuesi ka kundërshtuar vendimin për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, ndërsa në një gjykim të mëvonshëm ka kërkuar edhe kthimin e të gjitha sendeve të sekuestruara.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë lejuar kontrollin dhe sekuestrimin e sendeve dhe të dhënave kompjuterike me pretendimin se ato kishin cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor si dhe lirinë e shprehjes dhe të drejtën për jetë private.

Vlerësimi i Gjykatës

Legjitimimi – shterimi i mjeteve juridike referuar natyrës së vendimeve objekt kërkesë

Kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individit në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Nëse nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret për sa i përket vendimeve për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike kërkuesi kishte shteruar mjetet juridike, ndërsa në lidhje me sendet e tjera të sekuestruara ai nga ka ngritur një tjetër procedurë ankimore për të cilën pranoi se do t'i drejtohej Gjykatës me një ankim tjetër kushtetues individual.

Për themelin

Për cenimin e lirisë së shprehjes – Gjykata vlerësoi se, vendimet gjyqësore për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike kanë ndërhyrë në lirinë e shprehjes së kërkuetit si dhe kanë kufizuar lirinë e shtypit, në aspektin e identifikimit të burimeve që ai kishte për shkak të profesionit të gazetarit. Në verifikim të kriterëve të parashikuara nga neni 17, i Kushtetutës, Gjykata vlerësoi se, kriteri i parë i kufizimit “vetëm me ligj” ishte përmbushur. Në lidhje me kriterin e interesit publik Gjykata vlerësoi se, pyetja e kërkuetit për identifikimin e burimit dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të tij kanë pasur qëllime legjitime të administrimit të mirë të drejtësisë, mbrojtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si dhe të të drejtave themelore të të tjerëve. Këto kufizime kanë synuar edhe ndalimin e rrjedhjes së informacioneve të mbuluara nga sekreti hetimor që lidhen me një hetim në proces të krimit të organizuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale ndaj bashkëpunëtorit të drejtësisë, familjarëve të tij ose personave të tjerë.

Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata vlerësoi se, për sa i takon

qëllimit legjitim të parandalimit të rrjedhjes së informacionit dhe të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të bashkëpunëtorit të drejtësisë prokuroria dhe gjykatat e zakonshme kanë vepruar pa pritur efektet e urdhrit të sekretit hetimor, për rrjedhojë edhe pa analizuar përse ishte e nevojshme të përdorej me urgjencë mjeti i fundit, ai i sekuestrimit. Po kështu, gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar se përse marrja e të dhënave të nevojshme për hetimin mund të realizohej vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit të gazetarit, si mjet i fundit dhe i vetëm, pra përse nuk ekzistonin mjete të tjera alternative për të arritur qëllimin provues të sekuestrës. Për më tepër, vetë kërkueti nuk rezultoi të jetë subjekt i procedimit penal.

Gjykata çmoi se, nuk u arrit të provohet se prokuroria ka ndërmarrë veprime të tjera hetimore të mjaftueshme për zbulimin e autorëve të dyshuar të veprave penale. Kohëzgjatja e hetimeve për pothuajse një vit e gjysmë në raport me urgjencën prej 24 orësh të kryerjes së veprimeve ndërhyrëse në burimet e informacionit të kërkuetit është tregues se, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike nuk ka qenë mjeti i fundit hetimor, por ndër të parat për të kërkuar burimin e zbulimit të akteve sekrete hetimore. Gjithashtu ajo vlerësoi se, kërkuetit nuk i janë ofruar garancitë e nevojshme kushtetuese dhe konventore, me natyrë procedurale, për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe ruajtjen e burimeve të tjera të informacionit, ose materialeve konfidenciale.

Gjykata urdhëroi edhe asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara në provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe vendit të punës së kërkuetit.

Gjykata vlerësoi të mos ndalej në analizën e pretendimit për cenimin e jetës private për sa kohë gjeti shkelje në lirinë e shprehjes së kërkuetit.

Gjykata vendosi pranimin e kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta substanciale

Kohëzgjatja e afatit të masës së sigurimit "Arrest në shtëpi"

 Vendimi nr. 40, datë 17.06.2025

 Mimoza Margjeka

Gjykata e Lartë ndonëse e gjendur përpara një rregulli ligjor me përmbajtje të qartë (neni 237, pika 4 i Kodit të Procedurës Penale), duke përdorur disa metoda interpretimi ligjor, duket se ka krijuar në fakt normë të re procedurale sipas së cilës kohëzgjatja e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" është sa dyfishi i masës së sigurimit "Arresti në burg", duke tejkaluar kështu qëllimin e ligjit.

Mënyra e interpretimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të neneve 263 dhe 267 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) në lidhje me pikën 4, të nenit 237 të tij, nuk ka garantuar në mënyrë efektive lirinë personale të kërkueses.

Faktet

Kërkuesja është proceduar për veprën penale të korrupsionit pasiv dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO e shkallës së parë) ka vendosur ndaj saj masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", që u la në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO e Apelit) dhe Gjykata e Lartë. Gjatë kohës që çështja ishte në gjykim kërkuesja ka kërkuar shuarjen e masës për shkak të tejkalimit të afatit, kërkesë që është rrëzuar nga GJKKO-të e shkallës së parë dhe apelit me arsyetimin se afati i masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" është më i gjatë se sa masa e sigurimit "Arresti në burg". Kërkuesja paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, GJKKO-ja e shkallës së parë e deklaroi kërkuesen fajto

sipas akuzës, duke vendosur edhe shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi". Ky vendim u la në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit.

Në lidhje me rekursin për vendimin e shuarjes së masës, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin me arsyetimin se, çështja ka mbetur pa objekt, pasi masa e sigurimit nuk është në fuqi dhe kërkuesja është dënuar me vendim të formës së prerë. Pas ankimimit të kërkueses, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.17, dt. 13.03.2024, shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Lartë dhe ktheu çështjen për shqyrtim në po atë gjykatë. Pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e lirisë personale - Në rastin e masave të sigurimit që kufizojnë lirinë e individit, për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti veprojnë disa garanci të nivelit ligjor. Gjykata analizoi nëse interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për kohëzgjatjen e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi", ka cenuar garancitë procedurale të lirisë personale të kërkueses në atë masë sa rezultati në tërësi i kontrollit gjyqësor që gjykatat e zakonshme i kanë bërë kohëzgjatjes së masës së sigurimit është i padrejtë.

Gjykata çmoi se, Gjykata e Lartë duke përdorur disa metoda të interpretimit ligjor ka vlerësuar se, kohëzgjatja e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi", është sa dyfishi i masës së sigurimit "Arresti në burg". Në këtë mënyrë, përmes këtij interpretimi, kjo gjykatë i jep dyfishin e kohës organeve publike për të zhvilluar hetimet dhe gjykimin, duke tejkaluar qëllimin e ligjit për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti në kufizimin e lirisë personale. Dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mënyrë të ngushtë, pasi të drejtat individuale duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive. Interpretimi

i dispozitave procedurale penale nga ana e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk duket të jetë i arsyeshëm, duke i cenuar në këtë mënyrë kërkukses lirinë personale.

Për sa më sipër, Gjykata u shpreh vetëm për konstatimin e cenimit të lirisë personale, pasi masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” është shuar, ndaj dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuksen.

Gjykata vendosi pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të lirisë personale.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta substanciale

Ushtrimi i kontrollit në zyrën e subjektit privat gjatë ekzekutimit të një vendimi sekuestrimi

 Vendimi nr. 42, datë 01.07.2025

 Shoqëria "Studio Pustina" SHPK

Selia/zyra e personit juridik, ku ushtrohet veprimtaria profesionale, përbën mjedis të njëzuar me banesën në kuptim të nenit 37, të Kushtetutës, dhe nenit 8, të KEDNJ-së, ndaj paprekshmëria e saj është e garantuar.

Do të ishte joproporcionale që barra e provës t'i ngarkohej vetëm individit, ndërsa është në detyrimin e autoritetit publik të dokumentojë dhe provojë qartësisht masat dhe veprimet e ndërmarra, në veçanti kur ato prekin ose mund të prekin të drejta dhe liri kushtetuese.

Kodi i Procedurës Penale (KPP), megjithëse parashikon, si rregull, një shqyrtim paraprak gjyqësor, përjashtimisht, në raste urgjente, lejon të mos ketë një shqyrtim të tillë. Megjithatë, mungesa e një vendimi gjyqësor paraprak kontrolli të vendit apo të banesës mund të balancohet nga një shqyrtim gjyqësor efektiv ex post factum i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së kësaj mase hetimore, përfshirë edhe të kushtit të urgjencës së saj.

Kompetenca që KPP-ja i ka dhënë gjyqtarit për të vendosur për kontrollin e vendit apo të banesës synon kontrollin parandalues të kësaj mase nga një organ i pavarur dhe neutral. Organet e ndjekjes penale kanë detyrimin që rezerva ligjore e mbikëqyrjes paraprake gjyqësore, si një masë mbrojtëse e të drejtave themelore të individit, të jetë efektive në praktikë.

Faktet

Kërkueses, "Studio Pustina" SHPK, me veprimtari në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, i janë sekuestruar dokumente dhe kompjuterë që mund të përmbanin prova, në kuadër të hetimit të veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Hetimi kishte nisur më herët nga Prokuroria e Posaçme, përkundrejt klientit të saj, shoqërisë së ndërtimit "H" SHPK. dhe ortakëve të saj. Masa e sekuestritit u ekzekutua nga 3 OPGJ me urdhër të prokurorëve të çështjes, pas deklarimit të F.B administrator i shoqërisë "H" SHPK, se dokumentacioni financiar i shoqërisë në lidhje me aktivitetin e ndërtimit në pronën objekt hetimi, ishte mbajtur nga kërkuesja. Administratorja e kërkueses A.P, ka paraqitur ankim kundër vendimit të sekuestritit, i cili është rrëzuar nga GJKKO-ja e shkallës së Parë, konfirmuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe lënë sërish në fuqi nga Gjykata e Lartë.

Vlerësimi i Gjykatës

Për të drejtën e paprekshmërisë së banesës - Ndërhyrja në të drejtën e kërkueses ka konsistuar në zbatimin praktikisht të një mase kërkimi në zyrën e saj, e shoqëruar me sekuestrim, e cila për nga mënyra e zbatimit dhe efektet e saj praktike, në thelb, përbën një kontroll banese për efekt të zbatimit të nenit 37, të Kushtetutës, dhe nenit 8, të KEDNJ-së.

Fakti se, përfaqësuesja A.P. e kërkueses i ka lejuar OPGJ-të të futen në zyrë, apo se ajo ka bashkëpunuar me ta, nuk mund të interpretohet si dhënie pëlqimi për lejimin e tyre për të kërkuar në zyrën e saj, të sendeve, dokumenteve apo çdo gjëje tjetër me interes për hetimin penal që zhvillohej. Në këtë aspekt vlen parimi se, heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, në njohje të plotë

të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar dhe pa detyrim. Gjykata arriti në përfundimin se, ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkujes për paprekshmërinë e banesës.

Gjykata vëren se, kontrolli i vendit apo i banesës me iniciativë nga OPGJ-të, pa vendim të gjykatës, është një masë e lejuar nga Kodi i Procedurës Penale (KPP), por vetëm në kushte të përcaktuara rigorozisht prej saj, çështje që në thelb kërkon interpretimin e dispozitave ligjore. Gjykata vlerësoi të mos ndalej në mënyrë të veçantë në lidhje me respektimin e dispozitave të KPP-së për sa i përket masës së kontrollit të zbatuar nga OPGJ-të në kuadër të ekzekutimit të vendimit të sekuestrimit, por në lidhje me *proporcionalitetin e masës*.

Kontrolli (i kufizuar) në rastin konkret, ka synuar gjetjen e të dhënave dhe provave për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, me qëllim parandalimin dhe ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, çka përbën një qëllim të ligjshëm në aspekt të interesit publik, në kuptim të nenit 17, të Kushtetutës.

Për sa i përket *proporcionalitetit të ndërhyrjes*, Gjykata theksoi se, përveç mungesës së shqyrtimit paraprak gjyqësor, natyrës jo tërësisht të saktë të vendimit të sekuestrimit dhe faktit që kërkujes nuk i është garantuar e drejta për të qenë i pranishëm një person i besuar ose mbrojtësi i saj, në rastin konkret pavarësisht se gjykatat u vunë në lëvizje *ex post factum* mbi ankimin e kërkujes, shqyrtimi gjyqësor nuk ka qenë efektiv. Subjekti i interesuar dhe gjykatat e zakonshme në vijim nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre për të treguar arsye “relevante dhe të mjaftueshme” për të justifikuar zbatimin e një mase kontrolli në zyrën e kërkujes. Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në zyrën e kërkujes nuk ka qenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, pra nuk ka qenë proporcionale.

Për lirinë e veprimtarisë ekonomike -Nisur nga qëllimi i ligjshëm i ndërhyrjes, në kuptim të interesit publik, në raport me kohëzgjatjen e masës sekuestrimit, Gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin e kërkujes në lidhje me pajisjet kompjuterike të sekuestruara. Mbajtja e sekuestrimit në këtë hark kohor, ka ruajtur

një ekuilibër të drejtë mes interesit material të kërkujes dhe interesit publik për parandalimin dhe ndjekjen penale të veprës penale.

Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta substanciale

Cenimi i së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësisë së korrespondencës, si rrjedhojë e sekuestrimit dhe këqyrjes së telefonit celular

 Vendimi nr. 44, datë 29.07.2025

 Onejda Ymeraj

Në kontekstin e telefonave inteligjentë, aksesimi i të dhënave të memorizuara mund të shtrihet potencialisht në një spektër shumë të gjerë informacioni dhe të lejojë nxjerrjen e përfundimeve tejet të hollësishme mbi jetën private, profesionale dhe shoqërore të individit. Për këtë arsye, ndërhyrja shtetërore mbi të nuk mund të trajtohet si ndërhyrje mbi një send të zakonshëm provues, por si ndërhyrje në një hapësirë të zgjeruar të jetës private, me intensitet të lartë kushtetues. Për rrjedhojë, ndërhyrja në nenet 35 e 36, të Kushtetutës, dhe në nenin 8, të KEDNJ-së, duhet konsideruar në parim si “e rëndë” e në rrethana të caktuara, edhe si “veçanërisht e rëndë”, kur ajo prek të dhëna me natyrë sensitive.

Për të shmangur arbitraritetin, kërkimi, analiza, përzgjedhja e të dhënave duhet, si rregull, t’i nënshtrohet një verifikimi paraprak nga gjykata, i aftë të refuzojë ose të kufizojë masën kur ndërhyrja është joproporcionale.

Vendimi për masën e sekuestrimit duhet të përcaktojë, së paku, garancitë procedurale për minimizimin e ndërhyrjes, veçanërisht në drejtim të: (a) kufizimit të fushës së kërkimit, duke identifikuar pajisjen elektronike dhe, kur është rasti, sistemin ose sistemet e lidhura me të, si dhe duke përcaktuar objektin e kërkimit, llojin e të dhënave, fjalët kyçe ose kriteret e filtrimit dhe shtrirjen kohore, me synim shmangien e të dhënave të parëndësishme dhe, kur

është rasti, të atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji; (b) kufizimit të kohës së ruajtjes dhe të rrethit të ekspozimit të të dhënave, duke përcaktuar afate për ruajtjen dhe analizimin, si edhe personat e autorizuar për akses, në mënyrë që ndërhyrja të mos shndërrohet në një mbledhje të përgjithshme dhe të pakontrolluar të informacionit; (c) si dhe dokumentimit të detajuar të të gjitha veprimeve të kryera për kërkimin dhe analizimin e të dhënave, duke përfshirë mënyrën e aksesimit, kriteret e përdorura për kërkimin, të dhënat e përzgjedhura, si dhe masat e marra për garantimin e integritetit, me qëllim që të mundësohet një kontroll gjyqësor real dhe efektiv, në rast pretendimesh për arbitraritet, tejkalim të autorizimit ose shkelje të garancive procedurale.

Faktet

Kërkuesja është marrë në pyetje nga Prokuroria e Posaçme, si person që ka dijeni për veprën penale të korrupsionit në lidhje me një procedim penal të regjistruar ndaj dy shtetasve. Pas deklarimeve të saj, Prokuroria e Posaçme ka vendosur këqyrjen e telefonin celular të kërkueses, për të cilën kjo e fundit nuk ka pasur kundërshtime. Gjatë realizimit të këqyrjes nga OPGJ-të, kanë rezultuar komunikime me interes për hetimin, shkak për të cilin ata kanë sekuestruar sendin (“telefon celular”) të kërkueses, veprim i cili është vleftësuar i ligjshëm nga Prokuroria e Posaçme. Për këtë qëllim, kjo e fundit ka vendosur edhe kryerjen e ekspertimit elektronik për ekstraktimin e të dhënave në përmbajtje të telefonit celular.

Në kushtet e mospranimi nga prokurorët të kërkesës për kthimin e telefonit të saj celular, kërkuesja ka kundërshtuar gjyqësisht vendimin për sekuestrimin e tij. GJKKO-ja e Shkallës së

Parë ka pranuar kërkesën, me arsyetimin se sekuestrimi i telefonit ishte bërë pa vendim gjykatë dhe ka urdhëruar kthimin e tij kërkueses. Mbi ankimin e Prokurorisë së Posaçme GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin, duke rrëzuar kërkesën ankimore të kërkueses, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale- Gjykata vlerësoi se, të dhënat personale që përmban një telefon celular në përdorim të një individit përfshihen në fushën e mbrojtjes të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës.

Për të drejtën e fshehtësisë së korrespondencës - Gjykata theksoi se, mbrojtja e ofruar nga neni 36 i Kushtetutës, ka në qendër komunikimin në distancë të individit dhe përfshin krahas komunikimeve elektronike *in itinere* edhe ato statike. Kjo garanci shtrihet në çdo mjet që zhvillimet teknologjike e bëjnë të disponueshëm për qëllime komunikimi, përfshirë edhe ato mjete elektronike (si telefon inteligjent celular), të cilat kanë qenë të panjohura në kohën e miratimit të Kushtetutës.

a) Nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës – Gjykata vërejti se, sekuestrimi i telefonit celular dhe të dhënave (elektronike) personale e korrespondencës, si dhe aksesimi i tij, përmes kopjimit dhe ruajtjes të të dhënave që ai përmban, përbën ndërhyrje në nenet 35 e 36 të Kushtetutës. Kjo pasi masa e sekuestrit të telefonit celular nuk është thjesht sekuestrim i një objekti (sendi) në vetvete, por edhe sekuestrim i një “arkivi” të dhënash të ruajtura në të, përfshirë të dhënat personale dhe korrespondencës.

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar -në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së;

i.1) Nëse ndërhyrja është kryer me pëlqimin e kërkueses - Dorëzimi vullnetarisht i telefonit celular dhe nënshkrimi pa vërejtje i procesverbalit të sekuestrit nuk përbëjnë heqje dorë nga të drejtat kushtetuese dhe

dhënie pëlqimi për marrjen dhe përpunimin e të dhënave personale dhe të korrespondencës të memorizuara në telefon. Heqja dorë nga një e drejtë themelore mund të bëhet vetëm në bazë të pëlqimit të informuar, pra kur subjekti ka njohuri të plota për faktet relevante, përveçse duhet të shoqërohet dhe me garanci minimale në përpjesëtim me rëndësinë e së drejtës, çka nuk rezulton të jetë realizuar në rastin konkret. Për më tepër, individit duhet informuar paraprakisht dhe plotësisht për të drejtën për të refuzuar, qoftë edhe pjesërisht, marrjen dhe aksesimin, me qëllim përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale dhe të korrespondencës të memorizuara në telefon, ndërsa organi shtetëror duhet të garantojë praninë e avokatit përgjatë këtij procesi, kur kjo kërkohet. Në rastin e kërkueses, ndërhyrja në të drejtat e garantuara nga nenet 35 e 36 të Kushtetutës nuk është kryer me pëlqimin e saj.

i.2) Nëse ndërhyrja autorizohet nga ligji - Kërkimi i të dhënave kompjuterike që përfaqësojnë të dhëna personale ose korrespondencë private duhet, në parim, të autorizohet me vendim paraprak të gjykatës. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar mjaftueshëm, në mënyrë që ndërhyrja të kufizohet vetëm në atë që është rreptësisht e nevojshme për hetimin, duke shmangur arbitraritetin. Në rastet e ngutshme/të urgjencës, si përjashtim, interesi publik mund të justifikojë sekuestrimin e pajisjes elektronike dhe përkohësisht edhe të të dhënave të memorizuara në të, në tërësi, me iniciativë të OPGJ-së, pa vendim paraprak të gjykatës. Megjithatë, në këto raste masa i nënshtrohet kontrollit automatik të prokurorit dhe kontrollit gjyqësor *ex post* mbi ankimin e individit, ku ligjshmëria vlerësohet: së pari, në aspektin e urgjencës, e cila duhet të jetë reale, konkrete dhe e argumentuar në rrethanat specifike të rastit, dhe, së dyti, në aspektin e nevojës për qëllimet e procedimit penal, pra nëse kanë ekzistuar arsye të bazuara për të menduar se pajisja përmban të dhëna me rëndësi për hetimin.

-ii) Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm — Gjykata vërejti se, sekuestrimi i telefonit dhe i të dhënave kompjuterike të ruajtura me qëllim gjetjen e të dhënave për kryerjen e veprave penale të korrupsionit dhe pastrimit të produkteve të veprës penale ndjek një qëllim të

ligjshëm në aspekt të interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

-iii) Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë
– Gjykata vërejtë se, vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit i hartuar në terma të gjerë, duke mos kufizuar në mënyrë të arsyeshme fushëveprimin e masës, si dhe disponimi i prokurorisë për ekstraktimin, kopjimin dhe sekuestrimin në bllok të përmbajtjes së tij, pavarësisht nëse të dhënat e memorizuara në të kanë ose jo rëndësi për hetimin, duke lejuar sekuestrimin e të gjitha të dhënave në përmbajtjen e telefonit, si dhe shqyrtimin edhe të të dhënave që nuk kanë rëndësi për hetimin, shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e qëllimit legjitim, çka bën që ndërhyrja të mos jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, për rrjedhojë, joproportionale.

Gjykata vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta substanciale

Proporcionaliteti i shpërblimit si rrjedhojë e shpronësimit të pronës për interes publik

 Vendimi nr. 82, datë 18.12.2025

 Klodiana Cankja, Ermelinda Cankja, Ardit Cankja, Drita Cani, Suzana Cani, Marvis Cani, Engjell Tirana, Brian Tirana, Helga Hasekiu

Qëllimi i shpërblimit sipas nenit 41, pika 4, të Kushtetutës, është të rivendosë një gjendje “të barasvlershme me gjendjen e mëparshme”. Thelbi i garancisë kushtetuese është të garantojë ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës së individit, prej nga rrjedh detyrimi i prerë dhe i pakushtëzuar i shtetit për të siguruar një shpërblim të drejtë për shpronësimin. Ky shpërblim mund të korrespondojë me një vlerësim të plotë, por mund të jetë edhe më i ulët, pasi llogaritja e tij nuk merr në konsideratë vetëm interesin e individit të prekur, por e peshon atë në raport me interesin publik.

Autoritetet kompetente, gjatë procedurës së shpronësimit, dhe më tej gjykatat e zakonshme, gjatë procesit gjyqësor, duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e shpërblimit nga shpronësimi për të arritur ekuilibrin e duhur dhe për të mos i vendosur individit një barrë të tepruar.

Faktet

Këshilli i Ministrave ka shpronësuar dy prona (truall dhe ndërtesë) të kërkuarve sipas ligjit për shpronësimet, bazuar në kërkesën e bashkisë me qëllim sistemin e një rruge brenda qytetit. Me pretendimin se, vlera e shpërblimit nuk ishte

e drejtë, kërkuarve kanë paraqitur padi në gjykatë. Gjatë gjykimit është administruar akti i ekspertimit lidhur me përllogaritjen e shpërblimit sipas vlerës së tregut, e cila pothuajse e trefishonte shpërblimin e kërkuarve. Në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës e ka rrëzuar padinë, pasi, sipas saj, shpërblimi ishte llogaritur bazuar në aktet nënligjore në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, ndërsa akti i ekspertimit nuk kishte vlerë të paracaktuar provuese dhe nuk lidhej me provat e tjera të shqyrtuara. Sipas gjykatës, vlera e shpronësimit duhej përcaktuar sipas një metodologjie shtetërore, në mënyrë që të mos cenohej përmbushja e interesit publik. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa Gjykata e Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarve.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës - Kufizimi i ligjshëm i së drejtës së pronësisë kërkohet të realizohet me “ligj”, “vetëm për interesa publikë” dhe “vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë”, ndaj Gjykata analizoi nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për vlerën e shpërblimit, pra nëse përmbushet kriteri për proporcionalitetin e ndërhyrjes duke qenë se u provua që kërkuarve kanë pësuar ndërhyrje me ligj dhe për interes publik në të drejtën e pronësisë. Gjykata konstatoi se, megjithëse rekursi i kërkuarve për mungesën e arsytimit nga gjykata e apelit për shpërblimin e drejtë nga shpronësimi kishte të bënte me një shkelje potenciale të të drejtave kushtetuese, të cilën gjykatat e zakonshme kanë detyrimin ta shqyrtojnë me kujdesin e duhur, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur këtij pretendimi, i cili ishte vendimtar për zgjidhjen e çështjes. Për rrjedhojë, kërkuarve u janë cenuar të drejtat kushtetuese

të garantuara nga neni 42, i Kushtetutës, i lidhur me nenin 41, pika 4, të saj nga vendimi i Gjykatës së Lartë.

Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, e ktheu çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka asnjë pengesë ta zgjidhë vetë ose të orientojë zgjidhjen e saj nga gjykata më e ulët, duke njësuar e zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të trajtuara në këtë vendim.

Gjykata vendosi pranimin e kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta procedurale

Zëvendësimi i masave të sigurimit të vendosura më parë ndaj deputetit, me masën “Arrest në shtëpi”

 Vendimi nr. 1, datë 17.01.2025

 Sali Berisha

Edhe pse nga disa deklarata të anëtarëve të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, vërehen nuanca politike në trajtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme ose edhe paracaktimi i mënyrës së votimit të tyre, kjo është e pranueshme në kontekstin e diskutimeve në një institucion politik të përbërë nga përfaqësues të politikës, siç është Kuvendi, dhe nuk do të thotë se dhënia e autorizimit ka qenë e ndikuar politikisht.

Natyra e vendimeve të marra nga organet politike të Kuvendit, siç mund të jetë në rastin konkret Këshilli, të cilat në vetvete kanë natyrë politike, nuk mund të jetë e njëjtë me natyrën e një vendimi gjyqësor.

Faktet

Kërkuesi, politikan, ish-president dhe ish-kryeministër, aktualisht deputet i Kuvendit dhe kryetar i partisë kryesore opozitare, është akuzuar nga Prokuroria e Posaçme si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së, për kohën kur ka ushtruar funksionin e kryeministrit. Për këtë arsye, mbi kërkesën e organit të akuzës, gjykatat e zakonshme kanë caktuar ndaj tij dy masa sigurimi, konkretisht “Detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimin e daljes jashtë shtetit”. Duke qenë se detyrimi i vendosur në një nga këto masa nuk është

përmbushur nga kërkuesi, konkretisht “Detyrimi i për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, gjykatat kanë vendosur zëvendësimin e masave me masën “Arresti në shtëpi”.

Vlerësimi i Gjykatës

Për aspektet procedurale të cenimit të lirisë personale

Për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit - Sipas Gjykatës edhe pse nga disa deklarata të anëtarëve të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, vërehen nuanca politike në trajtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme ose edhe paracaktimi i mënyrës së votimit të tyre, kjo është e pranueshme në kontekstin e diskutimeve në një institucion politik të përbërë nga përfaqësues të politikës, siç është Kuvendi, dhe nuk do të thotë se dhënia e autorizimit ka qenë e ndikuar politikisht. Në vlerësimin e Gjykatës, natyra e vendimeve të marra nga organet politike të Kuvendit, siç mund të jetë në rastin konkret Këshilli, të cilat në vetvete kanë natyrë politike, nuk mund të jetë e njëjtë me natyrën e një vendimi gjyqësor. Në vlerësimin e Gjykatës, organi parlamentar që shqyrton kërkesën për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes dhe nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës apo bazueshmërinë e procedimit penal.

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Gjykata ka vlerësuar se, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Apelit), në vlerësimin e tyre për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për arsyet të cilat kanë justifikuar zëvendësimin e saj. Sipas Gjykatës edhe Gjykata e Lartë ka dhënë argumente të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e

përfundimit të çështjes. Për këto arsye, Gjykata ka vlerësuar se, vendimet e kundërshtuara nga kërkuesi përmbushin standardet e vendosur nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre.

Për cenimin e parimit të paanshmërisë – Gjykata ka vlerësuar se, qenia e kërkuesit në cilësinë e kryetarit të një organi kolegjal, i cili ka disponuar për lirimin nga detyra të gjyqtarës I.Gj., nuk është shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e asaj gjyqtareje në këtë rast, për sa kohë nuk rezulton dhe nuk është provuar që ai (kërkuesi), në cilësinë e kryetarit të atij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtim ose të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës apo të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se, veprimet e gjyqtarës I.Gj., në cilësinë e Zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, për caktimin e një gjyqtareje tjetër për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e saj nga shqyrtimi i çështjes, janë kryer në ushtrimin nga ajo të detyrave administrative dhe menaxhuese në drejtimin e asaj gjykate dhe lidhen vetëm me funksionin e saj si zëvendëskryetare, ndaj për këtë arsye nuk ndikojnë në paanshmërinë e saj.

Për aspektin substancial

Për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare - Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas njërit qëndrim, masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", e caktuar ndaj kërkuesit, nuk ka qenë proporcionale ndaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës për këtë shkak. Sipas qëndrimit tjetër, gjykatat e zakonshme kanë zbatuar në mënyrë të saktë dhe me mirëbesim zëvendësimin e dy masave të sigurimit në atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, duke vendosur ekuilibrin e duhur midis qëllimit për zbatimin e urdhrave të gjykatës, si dhe rëndësisë së lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur.

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Të drejta procedurale

Cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

 Vendimi nr. 67, datë 05.11.2025

 Aleksandër Fadili

Për të hetuar një zhdukje të dyshimtë dhe një vdekje të dyshimtë, analiza duhet të fillojë me zbulimin e trupit, të armës së krimit, të vendit të krimit, të motivit e të mekanizmit të vrasjes dhe në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar vlerën provuese të njollave të gjakut të lidhur me mungesën e një trupi në drejtim të fajësisë, për sa kohë që nuk rezultojnë të jetë gjetur as arma e krimit.

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar se, kërkuesi nuk ka bashkëpunuar për të treguar vendndodhjen e trupit të viktimës, por kjo nuk është e mjaftueshme për të justifikuar prezumimin e faktit.

Faktet

Kërkuesi ka bërë kallëzim penal në Komisaratin e Policisë Kurbin, pasi kishte humbur kontaktet me shokun e tij, me të cilin ishin edhe në marrëdhënie pune, shtetasin F.F. Prokuroria e Kurbin, pas veprimeve hetimore, ka marrë të pandehur kërkuesin, pasi sipas saj, ishin krijuar dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se shtetasi F.F. është vrarë me qëllim vjedhjen e shumës së të hollave që kishte pasur me vete dhe personi i fundit që ka pasur kontakt me të, ishte kërkuesi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka vendosur deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka

vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në datën 21.01.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimet e të trija gjykatave.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme - Gjykata vlerësoi se, kërkuesi nuk legjitimohet për efekt të shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi këtë pretendim nuk e ka parashtruar në ankim dhe as në rekurs ndonëse në këtë të fundit e ka cituar me fjalë të përgjithshme.

Për parimin e paanshmërisë, Gjykata vlerësoi se, nuk kishte paraqitur argumente në nivel kushtetues.

Për parimin e prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Gjykata për efekt të respektimit të garancive të parimit të prezumimit të pafajësisë analizoi tre kriteret: i) *Kriteri i parë, përcaktimi i drejtë dhe i qartë i fakteve të çështjes të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore*, për të cilin vlerësoi se, gjykatat nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktin që nuk ka një kufomë, nëse shtetasi F.F. është zhdukur ose është vrarë dhe pse është prezumuar si i tillë apo pse zhdukja është prezumuar si vrasje. (ii) *Kriteri i dytë, i zbërthyer në tre nënkriteret: përmbushja e detyrimit për barrën e provës duke evidentuar provat determinante (nënkriter i parë), respektimi i së drejtës për të mos u vetinkriminuar (nënkriter i dytë), nëse procesi ka filluar me bindjen se kërkuesi ka kryer veprën penale (nënkriter i tretë)*. Në përfundim të analizës për secilin nënkriter, në mënyrë të përmbledhur, Gjykata vlerësoi se: *Për nënkriterin e parë*, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë përpjekur të përmbushin detyrimin për barrën e provës, duke evidentuar disa prova shkencore determinante, të cilat janë vlerësuar në unitet me njëra-tjetrën.

Por, mënyra e arsyetimit të tyre duket sikur kanë çliruar prokurorin nga barra e provës dhe ia kanë kaluar kërkuesit, i cili sipas tyre, ka qenë në pozita mohuese dhe jo bashkëpunuese. *Për nënkriterin e dytë:* e drejtë për të mos u vetëinkriminuar është interpretuar në mënyrë arbitrare, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar ekzistencën e “mizorisë” në kryerjen e veprës penale, duke u bazuar vetëm në qëndrimin mohues të kërkuesit gjatë gjykimit, që ka refuzuar të tregojë trupin. *Për nënkriterin e tretë:* Gjykata vlerësoi se, nuk rezulton që të ketë filluar hetimi dhe gjykimi me dyshimin dhe paragjykimin se kërkuesi është fajtor për vrasjen e F.F., dhe se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të kishin analizuar dhe arsyetuar në mënyrë më të qartë lidhjen e faktit penal të vrasjes me kryerjen e vrasjes nga kërkuesi, në kushtet kur nuk është gjetur trupi i viktimës.

(iii) Kriteri i tretë: nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe prezumimet ligjore- Gjykata vlerësoi se, prezumimet e fakteve duhet të mbeten brenda kufijve të arsyeshëm, të cilët duhet të përcaktohen qartë përmes arsyetimit të vendimeve gjyqësore, që në rastin konkret duhet të fokusohet tek analiza përse fakti i vrasjes është prezumuar në kushtet e mungesës së trupit të viktimës, në analizë edhe të provave të tjera të grumbulluara në këtë proces penal. Nga vlerësimi i mësipërm, Gjykata arriti në konkluzionin se, mënyra e arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për prezumimin faktit të zhdukjes, vdekjes ose vrasjes dhe autorit të saj, nuk është e plotë dhe qartë. Ato kanë përmbushur në mënyrë jo të plotë detyrimin për t’iu përgjigjur kërkuesit në arsyetimin e vendimeve gjyqësore për pretendimet e tij *për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë*, duke ceduar në analizën e një raporti të drejtë dhe harmonik të të gjithë ansamblit të provave që provojnë fajësinë, qofshin ato determinante/ thelbësore të drejtpërdrejta ose indirekte, duke mbajtur në konsideratë se masa e kujdesit duhet të jetë në një nivel të arsyeshëm, për sa kohë jemi para një veprë penale, ku ashpërsia e masës së dënimit rrezikon ndjeshëm të drejtat kushtetuese substanciale.

Në përfundim, Gjykata vlerësoi se, Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formal dhe nuk ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit, arsyetimi

i të cilave ka qenë jo bindës, duke cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.

Për të lexuar dhe shkarkuar vendimin e plotë, ju lutem referojuni faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese në lidhjen: [Vendimi në PDF](#) ose skanoni kodin QR






Veprimtaria gjyqësore: Statistika

Kërkesa të regjistruara dhe vendime përfundimtare


Gjatë vitit 2025, në Gjykatën Kushtetuese:

- janë regjistruar **501** kërkesa të reja, të cilave u janë shtuar edhe **104** kërkesa të mbartura nga viti 2024, pra një total prej **605** kërkesash.
- ka dhënë në total **429** vendime (**85** vendime përfundimtare dhe **344** vendime moskalimi).*
- 173** kërkesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2026.

Vendimmarrje dhe çështje në shqyrtim gjatë vitit 2025




Tabelë krahasimore 2021-2025




* Numri përgjithshëm i vendimeve dhe çështjeve në shqyrtim nuk korrespondon me numrin total të kërkesave për shkak, të bashkimit/ ndarjes së kërkesave gjatë shqyrtimit.

Kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2025, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

Kërkesat e paraqitura sipas subjekteve



Kërkesat e paraqitura sipas subjekteve të tjera




Subjekti	Numri i kërkesave të paraqitura
Individët	485
Organizata jofitimprurëse	7
Jo më pak se 1/5-a, e deputetëve	4
Partitë politike	2
Gjykatat e sistemit të zakonshëm (Kontroll Incidental)	2
Presidenti i Republikës së Shqipërisë	1
Gjithsej	501


Kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2025, të grupuara sipas objektit të kërkesës:

Objekti i kërkesës	Numri i kërkesave të paraqitura
Kundërshtimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm	377
Kundërshtimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	59
Papajtueshmëria e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën	20
Konstatimi i cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	13
Interpretim/ korrigjim/ rishikim i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	10
Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën	7
Shfuqizimi i akteve të pushtetit publik	7
Shfuqizimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën	3
Shfuqizimi i vendimeve të Kuvendit të Shqipërisë	2
Konflikt kompetencash	2
Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese	1
Gjithsej	501

Kërkesat e reja të paraqitura sipas objektit në %



Kërkesat e paraqitura sipas objektit tjetër në %




- Kundërshtimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm
- Papajtueshmëria e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën
- Konstatimi i cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm
- Interpretim/ korrigjim/ rishikim i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese
- Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën
- Shfuqizimi i akteve të pushtetit publik
- Shfuqizimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën
- Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Shqipërisë
- Konflikt kompetencash
- Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

Vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese


Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të arsyetuara përfshirë edhe vendimet e moskalimit, të cilat janë të arsyetuara për kriteret e pranueshmërisë.

Lloji i vendimit	Numri i vendimeve të marra
Vendime Moskalimi nga Kolegjet	316
Vendime përfundimtare	85
Vendime Moskalimi nga Mbledhja e Gjyqtarëve	28
Gjithsej	429

Vendimarrja 2025




Vendimet përfundimtare sipas subjekteve në %



Subjektet që kanë vënë lëvizje gjykatën	Numri i vendimeve përfundimtare të marra
Individët	74
Grup deputetësh	4
Organizatrat jofitimprurëse	3
Presidenti i Republikës	2
Gjykatat e zakonshme (kontroll incidental)	2
Gjithsej	85


Vendimet përfundimtare të grupuara sipas objektit të kërkesës:

Vendimet përfundimtare sipas objektit të kërkesës në %



Objekti i kërkesës	Numri i kërkesave të paraqitura
Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm	56
Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	13
Papajtueshmëria e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën	6
Konstatimi i cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	3
Korrigjim/ shpenzime gjyqësore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	2
Shfuqizimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën	2
Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese	2
Konflikt kompetencash	1
Gjithsej	85

Vendimet përfundimtare sipas objektit tjetër në %




- Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm
- Papajtueshmëria e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën
- Konstatimi i cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm
- Korrigjim/ shpenzime gjyqësore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese
- Shfuqizimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën
- Konflikt kompetencash

Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:

Lloji i dispozitivit të vendimit	Numri i vendimeve
Pranim i pjesshëm i kërkesës	33
Pranim i kërkesës	28
Rrëzim i kërkesës	23
Pushim i çështjes	1
Gjithsej	85

Vendimet sipas llojit të dispozitivit




- Pranim i pjesshëm i kërkesës
- Pranim i kërkesës
- Rrëzimi i kërkesës
- Pushimi i çështjes

Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas mënyrës së votimit:


Lloji mënyrës së votimit	Numri i vendimeve
Njëzëri	53
Shumicë votash	28
Pa kuorum	4
Gjithsej	85

Vendimet sipas mënyrës së votimit




Gjatë vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ka marrë 344 vendime moskalimi, 28 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe 316 nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese.

Vendimet e moskalimit 2025



Vendimet e moskalimit të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje gjykatën:


Vendimet e moskalimit sipas subjektit



Subjektet që kanë vënë lëvizje gjykatën	Numri i vendimeve të moskalimit
Individët	337
Organizatrat jofitimprurëse	4
Gjykatat e zakonshme (kontroll incidental)	2
Partitë politike	1
Gjithsej	344


Vendimet e moskalimit të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas objektit të kërkesës:

Vendimet e moskalimit sipas objektit të kërkesës në %



Objekti i kërkesës	Numri i vendimeve të moskalimit
Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm	276
Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	24
Papajtueshmëria e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën	17
Konstatimi i cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	17
Interpretim/ korrigjim/ rishikim i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	8
Shfuqizimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me papajtueshmërinë e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre)	2
Gjithsej	344

Vendimet e moskalimit sipas objektit Tjetër në %



Perspektiva ndërkombëtare

Dialogu gjyqësor

Në një kontekst juridik dhe kushtetues gjithnjë e më të ndërlidhur, drejtësia kushtetuese nuk mund të konceptohet më vetëm brenda kufijve kombëtarë. Sfidat me të cilat përballen sot gjykatat kushtetuese, duke filluar nga mbrojtja e të drejtave e lirive themelore dhe sundimi i ligjit, deri te ruajtja e qeverisjes demokratike, ndahen shpesh ndërmjet juridiksioneve të ndryshme dhe kërkojnë dialog të vazhdueshëm, mirëkuptim reciprok dhe bashkëpunim ndërmjet gjykatave në nivel ndërkombëtar dhe rajonal.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë mbetet e vendosur në angazhimin e saj për të forcuar bashkëpunimin me partnerët gjyqësorë ndërkombëtarë dhe rajonalë, duke konsideruar se dialogu kushtetues krahasues përbën një komponent thelbësor të gjykimit kushtetues modern. Pjesëmarrja në rrjete ndërkombëtare, shkëmbime dypalëshe dhe forume multilaterale ka bërë të mundur që Gjykata Kushtetuese shqiptare njëkohësisht të kontribuojë dhe të përfitojë nga përvoja kolektive e juridiksioneve kushtetuese dhe supreme. Kjo qasje ka promovuar konvergjencën e standardeve kushtetuese, duke ruajtur në çdo rast respektimin e identitetit kushtetues kombëtar.

Gjatë vitit 2025, një rëndësi e veçantë i është kushtuar zbatimit në praktike të Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruara mes Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe gjykatave simotra. Këto bashkëpunime institucionale janë konkretizuar nëpërmjet zhvillimit të dy

vizitave të punës në nivel teknik dhe profesional, si shkëmbime mes strukturave respektive të këshilltarëve ligjorë dhe drejtorisë së studimeve. Vizita e parë është organizuar pranë Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe vizita e dytë pranë Gjykatës Kushtetuese të Spanjës. Këto shkëmbime ofruan mundësinë e trajtimit të temave të ndryshme mbi jurisprudencën kushtetuese, duke forcuar lidhjet profesionale dhe duke lehtësuar shkëmbimin praktik të përvojës ndërmjet stafeve administrative përkatëse.

Gjithashtu, Gjykata ka intensifikuar bashkëpunimin me Gjykatën Evropiane të të Drejtave e Njeriut (GJEDNJ) përmes realizimit të tri vizitave studimore: dy pranë GJEDNJ-së dhe një pranë Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së në Këshillin e Evropës. Dy vizitat e para, të realizuara përkatësisht në maj dhe korrik 2025, u mundësuan gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë njohjen më nga afër të qëndrimeve dhe standardeve më të fundit të GJEDNJ-së në lidhje me çështje e tematika me interes të ndërsjellë në respektim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Vizita e fundit e realizuar në dhjetor 2025, e cila kishte në fokus ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, kontribuoi në harmonizimin e praktikës kushtetuese kombëtare me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, si edhe nxiti pjesëmarrjen e Gjykatës në mënyrë efektive në mekanizmat rajonalë për monitorimin dhe ekzekutimin e vendimeve kushtetuese, duke konsoliduar rolin e saj brenda kuadrit më të gjerë gjyqësor evropian.

Partnerët ndërkombëtarë

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe projektet e asistencës së huaj zë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë institucionale të Gjykatës Kushtetuese. Ai mbetet thelbësor për realizimin efektiv të objektivave strategjike dhe prioritetet e saj. Në këtë kuptim, nismat e ndërmarra gjatë vitit 2025, dëshmuuan përpjekjet e vazhdueshme të Gjykatës për forcimin e këtij bashkëpunimi në funksion të rritjes së cilësisë së jurisprudence kushtetuese.

Me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe ndihmën e Fondacionit Konrad Adenauer, Gjykata finalizoi dhe botoi udhërrëfyesin e dytë të jurisprudence së saj, i cili përmbledh vendimmarrjen e kësaj gjykate për periudhën 1992 – 2024 në lidhje me parimet e së drejtës, ndarjen e pushteteve, si dhe të drejtat kushtetuese substanciale. Mbështetja e partnerëve në këtë nismë erdhi në vazhdimësi të punës së përbashkët për realizimin e udhërrëfyesit të parë të jurisprudence, i prezantuar në shkurt të vitit 2024. Të dy këto botime përbëjnë mjete të rëndësishme për njohjen e praktikës kushtetuese dhe për sistemimin e saj, duke e bërë vendimmarrjen e Gjykatës edhe më të aksesueshme, jo vetëm për studiuesit e akademikët, por edhe të gjithë profesionistët e së drejtës.

Gjithashtu, në partneritet me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Drejtësi (IRZ), u organizuan dy vizita studimore pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Po ashtu, në kuadër të këtij partneriteti u zhvilluan seminare në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë mbi ankimin kushtetues individual, të cilat kontribuan në njohjen e avokatëve me zbatimin e këtij

mekanizmi në juridiksionin gjerman dhe atë vendas.

Në funksion të modernizimit teknologjik dhe përmirësimit të mëtejshëm të administrimit të çështjeve, Gjykata thelloi bashkëpunimin me Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë duke punuar për një projekt konkret që ka si qëllim ngritjen e një sistemi bashkëkohor të menaxhimit të çështjeve dhe digjitalizimin e arkivit të saj, projekt i cili pritet të financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Ky projekt synon rritjen e efikasitetit administrativ, përmirësimin e transparencës institucionale, krijimin e një arkivi funksional dhe të aksesueshëm, si dhe përmirësimin e gjurmueshmërisë së çështjeve, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit të proceseve të punës.

Në tërësi, mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë gjatë vitit 2025 ka qenë mjaft e rëndësishme sa i takon shkëmbimit të përvojave profesionale me juridiksione të tjera, të cilat ndihmojnë harmonizimin e standardeve të punës me praktikën evropiane dhe zhvillojnë më tej mendimin kushtetues. Duke integruar sistematikisht perspektivat krahasuese dhe evropiane, Gjykata Kushtetuese konfirmon përkushtimin e saj në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe të drejtave e lirive themelore të qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkëpunimi ndërkombëtar do të vijojë të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale, avancimin e standardeve profesionale dhe konsolidimin e rolit të Gjykatës në sistemin kushtetues shqiptar.

Përfaqësimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Takimi Përgatitor i Rrethit të Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC) – 28 shkurt 2025, Tiranë, Shqipëri

Në kuadër të kryesimit të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC) për periudhën 2024 - 2027, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë organizoi në Tiranë Takimin Përgatitor të Rrethit të Kryetarëve, i cili është një prej organeve drejtuese dhe vendimmarrëse të kësaj Konference. Gjatë këtij takimi u miratuan çështje organizative të Kongresit të ardhshëm XX-të të CECC, i cili do të zhvillohet në Shqipëri në vitin 2027, duke përcaktuar temën dhe datën e zhvillimit të këtij Kongresi, si dhe çështje të tjera të propozuara nga gjykatat kushtetuese anëtare. Një nga momentet më të rëndësishme

të takimit përgatitor ishte votimi dhe pranimi nga shumica e gjykatave kushtetuese anëtare të CECC i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për anëtarësinë me të drejta të plota në këtë organizëm, duke shënuar një moment historik për këtë gjykatë pas një përpjekjeje 14-vjeçare për të qenë pjesë integrale e rrjetit evropian të gjykatave kushtetuese.

Ky takim përgatitor përbën një hap të rëndësishëm drejt suksesit të Kongresit XX-të, duke forcuar rolin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare dhe duke kontribuar në zhvillimin e drejtësisë kushtetuese në rajon dhe në Evropë.





▀ *Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë merr pjesë në Kongresin e X-të të Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone, 6 – 8 maj 2025, Bukuresht, Rumani*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë zgjidhet për herë të parë nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone, e mbledhur në kuadër të Kongresit të X-të të kësaj shoqate, si anëtare e Byrosë së saj drejtuese. Byroja është një prej organeve drejtuese të ACCF, e cila përbëhet nga 10 gjykata kushtetuese anëtare dhe rinovohet periodikisht për një periudhë tre vjeçare.

▀ *Takimi i 8-të i Rrjetit të Gjykatave Supreme (SCN), 5 – 6 qershor 2025, Strasburg, Francë*

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në takimin e 8-të të Forumit Vjetor të Rrjetit të Gjykatave Supreme (Superior Courts Network – SCN). Takimi i vitit 2025 pati një rëndësi të veçantë pasi shënoi 10- vjetorin e krijimit të Rrjetit të Gjykatave, si dhe 75-vjetorin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjatë sesioneve u evidentua rëndësia e Rrjetit në zbatimin efektiv të Konventës Evropiane për

të Drejtat e Njeriut, si një platformë efektive e dialogut gjyqësor për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës mes gjykatave dhe GJEDNJ-së. Pjesëmarrja e Gjykatës Kushtetuese në këtë veprimtari u mbështetet nga projekti “Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri (D-REX III)”, përmes programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Horizontal Instrument for the Western Balkans and Türkiye”.





▤ *Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë drejton takimin e grupimit rajonal të CECC në kuadër të pjesëmarrjes në Kongresin e VI-të të Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese – 28 tetor 2025, Madrid, Spanjë*

Kongresi i VI-të i Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese u parapri nga takimet e grupimeve rajonale dhe linguistike të organizmave aderuese dhe, në cilësinë e Kryetares së Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë drejtoi takimin e grupimit rajonal të CECC, si dhe e përfaqësoi këtë grupim rajonal në takimin e Byrosë drejtuese të Konferencës Botërore.

Gjatë këtij takimi Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë bëri një prezantim të veprimtarisë së deritanishme të CECC nën kryesimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe në vijim mori pjesë dhe e përfaqësoi Konferencën Evropiane në Byronë e Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese, duke përcjellë qëndrimet dhe

vendimmarrjen e gjykatave evropiane. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mori pjesë në takimin e grupimit të gjykatave kushtetuese frankofone (ACCF), si anëtare me të drejta të plota dhe anëtare e Byrosë drejtuese të kësaj Shoqate.

▤ *Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë merr pjesë në Kongresin e 6-të të Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese (WCCJ), 28 – 30 tetor 2025, Madrid, Spanjë*

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në këtë Kongres në dy cilësi, si kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC) dhe si anëtare e Byrosë drejtuese të WCCJ.

Nën temën kryesore të këtij Kongresi “Të drejtat e njeriut të gjeneratave të ardhshme”, gjykatat pjesëmarrëse trajtuan dhe analizuan në kontekstin e drejtësisë kushtetuese dimensionet individuale dhe kolektive të drejtësisë ndërmjet brezave, të tilla si ruajtja e mjedisit dhe e burimeve natyrore, mbrojtja e trashëgimisë kulturore të njerëzimit, aksesit në njohuritë shkencore dhe teknologjitë e reja, si dhe pavarësia gjyqësore.

▤ *Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë merr pjesë në Takimin e 3-të Vjetor të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit (BCCF), Antalia, Turqi, 14 - 15 nëntor 2025*

Takimin i 3-të Vjetor i Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit u organizua nën kujdesin e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë dhe



në të morën pjesë përfaqësues nga gjykatat anëtare të Forumit, gjyqtarë të GJEDNJ-së, si dhe gjykata e personalitete të tjera të ftuara vendase dhe ndërkombëtare. Një sesion i posaçëm iu dedikua edhe diskutimeve rreth aspekteve teknike dhe organizative të Forumit.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë u përfaqësua në këtë veprimtari nga gjyqtare Sonila Bejtja, e cila mbajti edhe një prezantim në Konferencën Ndërkombëtare që u zhvillua me këtë rast, me temë: *“Standardizimi i të drejtave të njeriut dhe roli i drejtësisë kushtetuese”*.

▀ *Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë merr pjesë në tryezën e rrumbullakët në kuadër të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, 8 dhjetor 2025, Prishtinë, Kosovë*

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mori pjesë në aktivitetin me temë: *“Sfidat dhe praktikat më të mira në komunikimin e vendimeve të profilit të lartë të gjykatave kushtetuese: Një analizë krahasuese”*, i cili u organizua me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, në kuadër të veprimtarive të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit. Në këtë veprimtari morën pjesë Sekretarë të Përgjithshëm dhe përfaqësues të stafeve administrative që mbulojnë marrëdhëniet me publikun dhe mediat nga Gjykatat Kushtetuese të Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut,

Turqisë, Kosovës, si dhe i ftuari i posaçëm nga Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke.

Emëruesi i përbashkët i diskutimeve ishte përpjekja e gjykatave për të respektuar parimet e transparencës, paanshmërisë dhe pavarësisë institucionale, si dhe për t’u përshtatur më së miri edhe me teknologjitë e reja të komunikimit.

▀ *Vizitë studimore e këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe Drejtorisë së Kërkimit Ligjor, Studimeve dhe Botimeve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 6 – 7 maj 2025, Strasburg, Francë*

Kjo vizitë dy ditore u organizua me mbështetjen e Fondacionit Gjerman për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar (IRZ), si dhe në bashkërendim me Zyrën e Gjyqtarit të zgjedhur për Shqipërinë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të



Njeriut (GJEDNJ), z. Darian Pavli. Gjatë vizitës, pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjonin nga ekspertët e GJEDNJ-së mbi jurisprudencën dhe qëndrimet e Gjykatës lidhur me disa nga të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ata gjithashtu u informuan mbi procedurën e shqyrtimit të çështjeve, mbi risitë e metodologjisë së kërkimit në platformat e GJEDNJ-së si HUDOC dhe Knowledge Sharing, si edhe diskutuan mbi qëndrimet e GJEDNJ-së në lidhje me disa nga çështjet që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe veçanërisht me disa aspekte të gjykimit kushtetues.

Vizitë e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), 3 – 4 korrik 2025, Strasburg, Francë

Qëllimi i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimi i përvojave më të mira sa i takon mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit. Vizita u realizua në bashkëpunim me Zyrën e Gjyqtarit të Zgjedhur për Shqipërinë në GJEDNJ, z. Darian Pavli, si dhe me mbështetjen e Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor (IRZ), përmes fondeve të Zyrës Federale Gjermane të Marrëdhënieve me Jashtë.

Vizitë e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Barit, Itali, 17 – 18 korrik 2025

Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni i gjykatës është pritur në ambientet e Rektoratit të Universitetit të Barit nga Prof. Andrea Lovato, Drejtor i Departamentit të Jurisprudencës, dhe profesorë të tjerë të së drejtës kushtetuese, për të vijuar me sesionet e prezantimeve dhe diskutimeve për temat: “Pikëprerjet ndërmjet jurisprudencës italiane dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë” dhe “Kontrolli Incidental”. Po ashtu, delegacioni ka vizituar edhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike të Universitetit, takim gjatë të cilit u zhvilluan diskutime për çështje me interes të përbashkët në fushën e të drejtës kushtetuese, si dhe mbi ecurinë e reformës gjithëpërfshirëse në



drejtësi në Shqipëri, duke nënvizuar rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm ndërmjet gjykatave dhe institucioneve akademike për zhvillimin e mendimit juridik dhe përmirësimin e praktikave kushtetuese.

Vizitë studimore e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë pranë Gjykatës Kushtetuese të Spanjës, Madrid, 11 – 12 shtator 2025

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të ndërsjellë në fusha me interes të përbashkët, të nënshkruar me Gjykatën Kushtetuese të Mbretërisë së Spanjës në mars të vitit 2024, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë zhvilloi një vizitë studimore pranë Gjykatës Kushtetuese të Spanjës.



Gjatë vizitës studimore u zhvilluan disa sesione pune me tematika të ndryshme me interes për të dyja gjykatat. Këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Spanjës ndanë me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë qëndrimet dhe jurisprudencën e konsoliduar mbi disa tema, veçanërisht mbi atë të mekanizmit të ankimit kushtetues individual.

Vizitë studimore e përfaqësuesve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë pranë Këshillit të Shtetit të Greqisë, Athinë, 27 nëntor 2025

Në vijim të marrëdhënieve shumë të mira të bashkëpunimit me Këshillin e Shtetit të Greqisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë ka zhvilluar një vizitë studimore pranë këtij institucioni, në fokus të së cilës ka qenë diskutimi mbi bashkëpunimin e deritanishëm



dhe mënyrat e thellimit të këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Po ashtu, delegacioni shqiptar është pritur në një takim të posaçëm nga Kryetari i Këshillit të Shtetit të Greqisë, z. Michail Pikramenos, si dhe ka pasur mundësinë të njihej më nga afër me rolin, strukturën dhe funksionet e Këshillit të Shtetit të Greqisë, gjatë takimeve të zhvilluara me homologët, me qëllim shkëmbimin e përvojave përkatëse ndërmjet dy institucioneve kushtetuese.

Vizitë punë e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Strasburg, Francë, 8 – 9 dhjetor 2025

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarë dhe këshilltarë ligjorë, ka zhvilluar një vizitë pune në Departamentin për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së. Qëllimi i kësaj vizite pune, e cila u organizua edhe me mbështetjen e Këshillit të Evropës, ishte shkëmbimi i qëndrimeve dhe pikëpamjeve me përfaqësuesit e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-



së, Sekretariatit të Komitetit të Ministrave, Asamblesë Parlamentare, Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës të Këshillit të Evropës, për sa i përket ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së për Shqipërinë, evidentimit të praktikave më të mira, si dhe të sfidave që lidhen me procesin e ekzekutimit të vendimeve dhe drejtësinë kushtetuese në përgjithësi.

Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese zhvilloi një takim pune edhe me gjyqtarin për Shqipërinë në GJEDNJ, z. Darian Pavli, gjatë të cilit u diskutua në lidhje me forcimin e dialogut gjyqësor, rolin e Gjykatës Kushtetuese si një filtër paraprak i kërkesave që i drejtohen GJEDNJ-së, si dhe kontributin e të dyja gjykatave në garantimin e të drejtave themelore të individëve.

▀ *Ceremonia e Hapjes së Vitit Gjyqësor 2025 të Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Italisë, Romë, 23 – 24 janar 2025*

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë mori pjesë në veprimtaritë e zhvilluara me rastin e hapjes së vitit gjyqësor të Gjykatës së Lartë të Kasacionit, në kuadër të të cilave, përfaqësuesit e shtetit shqiptar kanë zhvilluar takime në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë të Kasacionit, si dhe në Presidencë. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar për forcimin e bashkëpunimit dhe dialogut ndërinstitucional, duke thelluar më



tej marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve tona. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka shprehur gatishmërinë për të ndarë përvojat dhe praktikat më të mira, duke marrë në konsideratë afrimitetin dhe ngjashmërinë mes dy sistemeve tona kushtetuese dhe juridike, si dhe aspektet kulturore të ndërlidhura.

▀ *Ceremonia e Hapjes së Vitit Gjyqësor 2025 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg, Francë, 31 janar 2025*

Në kuadër të këtyre veprimtarive u zhvillua seminari me temë “Mbrotjtja e të drejtave të njeriut në botën e inteligjencës artificiale, algoritmeve dhe të dhënave masive”, i cili u pasua me Seancën Solemne të Hapjes së Vitit Gjyqësor 2025, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo është një nga ngjarjet më të rëndësishme në kalendarin e drejtësisë evropiane, e cila mbledh së bashku kryetarë dhe përfaqësues të lartë të gjykatave kushtetuese dhe supreme nga vende të ndryshme anëtare të Këshillit të Evropës.



▀ *Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes “Kongresi Botëror i Ligjit 2027”, Madrid, Spanjë, 7 – 8 shkurt 2025*

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë mori pjesë në ceremoninë e parashikuara me rastin e akordimit të çmimit Premio Espanol Universal 2024 për z. Javier Cremades, Kryetar i Shoqatës Botërore të Juristëve (WJA), në njohje të kontributit të tij të shquar për promovimin ndërkombëtar të Spanjës dhe komunitetit ligjor spanjoll. Në kuadër të ceremonisë për akordimin e këtij çmimi është zhvilluar një audiencë me Mbretin e Spanjës, Madhërinë e Tij, Felipe VI. Gjatë audiencës është nënshkruar



në një ceremoni të posaçme marrëveshja "Kongresi Botëror i Ligjit 2027", i cili do të zhvillohet në Tiranë, për të mbledhur së bashku ekspertë nga e gjithë bota, si një mundësi e shkëlqyer për shkëmbimin e njohurive, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e vlerave demokratike të shtetit të së drejtës.

▀ *Forumi i Tretë i Barazisë Gjinore për Ballkanin Perëndimor, 7 mars 2025, Shkup, Maqedonia e Veriut*

Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Marjana Semini, mori pjesë në Forumin e Tretë të Barazisë Gjinore për Ballkanin Perëndimor, i organizuar nga Qendra Aire me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, dhe në bashkëpunim me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Diskutimet gjatë këtij Forumi u përqendruan në rolin e gjyqësorit për avancimin e barazisë gjinore, veçanërisht në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, sfidimin e stereotipeve në arsyetimin gjyqësor dhe luftën ndaj diskriminimit. Gjithashtu, u vu theksi te nevoja për zbatimin



efektiv të standardeve dhe jurisprudencës më të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe forcimin e qasjes institucionale për mbrojtjen e të drejtave të grave.

▀ *Konferencë Ndërkombëtare e organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Letonisë, Riga, 25 prill 2025*

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: "Roli i gjykatave kushtetuese në forcimin e vlerave evropiane të përbashkëta përballë sfidave bashkëkohore," në kuadër të projektit "Mbështetje për zhvillimin e drejtësisë kushtetuese në Ukrainë", dhe të realizuar si pjesë e Fazës së III-të të Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Partneriteti për Mirëqeverisje".



▀ *63 vjetori i Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, Ankara, 25 - 26 prill 2025*

Veprimtaritë e organizuara me rastin e këtij përvjetori përfshinë një sesion të dedikuar dhe ceremoninë e hapjes së veprimtarive festive, si dhe simpoziumin ndërkombëtar me temë "E ardhmja e drejtësisë kushtetuese në shekullin e 21-të".





▀ *Kongresi i 29-të Botëror i Ligjit, Santo Domingo, Republika Dominikane, 5 – 8 maj 2025*

Me ftesë të World Law Foundation & World Jurist Association, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ka marrë pjesë në Kongresin e 29-të Botëror të Ligjit, i cili u organizua me disa tryeza diskutimesh ku pati referime nga panelistë të ndryshëm nga e gjithë bota. Përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese moderuan dhe referuan në disa prej paneleve. Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese drejtoi panelin me titull: “Drejtësia Kushtetuese në Vështrim Krahësues I”; gjyqtarja Sonila Bejtja drejtoi panelin me titull: “Konfliktet Kushtetuese të Juridiksionit midis Qeverive Qendrore dhe Federale”; gjyqtari Gent Ibrahim i referoi në panelin me titull: “Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese”.

▀ *150-vjetori i Tribunalit Federal të Zvicrës, Lozanë, 15 – 16 maj 2025*

Me rastin e këtij përvjetori të rëndësishëm, Tribunali Federal i Zvicrës organizoi edhe Simpoziumin shkencor me referues gjyqtarë dhe akademikë të së drejtës, të cilat trajtuan problematika të ndryshme si: Tribunali Federal: forcë lëvizëse që çon përpara shoqërinë apo pasqyrim i kësaj shoqërie; rregullat e procedurës që pengojnë aksesin te gjyqtari kushtetues; perspektiva e GJEDNJ-së në shterimin e mjeteve juridike vendase; njohja e të drejtave themelore të pashkruara; roli i gjyqtarit – zëdhënës i ligjit apo krijues i së drejtës pretoriane; etj.



Data të rëndësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar

Marrëveshja për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë me Gjykatën Kushtetuese të Italisë.

**16 korrik
2009**

Marrëveshja për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë me Gjykatën Kushtetuese të Turqisë.

**9 – 12
qershor
2013**

Memorandumi i Mirëkuptimit me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

**14 prill
2021**

Marrëveshja e Bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Spanjës.

**5 mars
2024**

Rivitalizohet Marrëveshja e Bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Italisë.

**25
shtator
2024**

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë zgjidhet për herë të parë nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone si anëtare e Byrosë së saj.

**6-8 maj
2025**

**18 – 20
prill 2011**

Marrëveshja për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

**29
shtator
2021**

Marrëveshja e re me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

**19 shkurt
2024**

Marrëveshja Kuadër për Bashkëpunimin Institucional me Dhomën e Avokatisë të Shqipërisë.

**22 – 24
maj 2024**

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë zgjidhet si gjykata kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane 2024 – 2027.

**28 shkurt
2025**

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, si kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC), zhvilloi në Tiranë Takimin Përgatitor të Rrethit të Presidentëve, një nga organet drejtuese dhe vendimmarrëse të Konferencës.

Aktivitete brenda vendit

▣ *Takim i trupës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë me Ambasadorin e BE-së në Shqipëri, Sh.T.Z. Silvio Gonzato, 6 mars 2025*

Trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë ka zhvilluar një takim zyrtar me kreun e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ambasadorin Silvio Gonzato. Duke e vënë theksin në rëndësinë që mbart realizimi me sukses i reformave, si dhe niveli i ndërveprimit me autoritetet publike, Ambasadori Gonzato shprehu vlerësimet e tij pozitive për veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese, e cila që nga plotësimi i saj, në një kohë të shkurtër, ka dhënë dyfishin e vendimeve në krahasim me pak vite më parë, duke rritur kështu besimin te publiku. Gjithashtu, Ambasadori Gonzato vuri në pah se marrja e Presidencës së CECC-së është një faktor shumë i rëndësishëm për Shqipërinë, sepse kjo do të mundësojë krijimin e një rrjeti me gjykatat evropiane që kanë kaluar më parë proceset integruese për njohjen dhe zbatimin e *acquis communautaire*.



▣ *Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Gjykatës Kushtetuese të Italisë, 21 mars 2025*

Gjykata Kushtetuese zhvilloi tryezën e rrumbullakët me temë: “Avancimi i mëtejshëm i kërkimit dhe arsyetimit ligjor për një vendimarrje kushtetuese efektive dhe cilësore”.

Kjo veprimtari mbledhi së bashku këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë si dhe përfaqësues të Gjykatës Kushtetuese të Italisë për të ndarë përvoja dhe praktika të avancuara në fushën e arsyetimit juridik dhe të kërkimit shkencor kushtetues.

▣ *Seminar trajnues për këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, 11 prill 2025*

Në kuadër të projektit të shkëmbimit midis Zyrës Gjyqësore të Anglisë dhe Uellsit dhe Shkollës së Magjistraturës në Shqipëri, me mbështetjen edhe të Ambasadës Britanike në Tiranë, u zhvillua seminari trajnues me këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkrimin dhe arsyetimin ligjor të vendimeve gjyqësore si dhe me përdorimin e precedentit. Seminari u moderua nga tre gjyqtarë britanikë me përvojë në fusha të ndryshme të së drejtës, Gjyqtare Eady, HHJ Keith Raynor dhe Gjyqtari Sufiyan Rana.





Temat e trajtuara gjatë këtij seminari trajnues ishin: *Rregullat praktike për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve të gjykatës; si dhe Metodologjia e zbatuar për përdorimin e precedentëve dhe referimi i precedentëve në common-law.*

▀ *Vizitë e pedagogëve dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë në Gjykatën Kushtetuese, 24 prill 2025*

Gjykata Kushtetuese mirëpriti në ambientet e saj Zëvendësdekanin e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Prof. Asoc. Dr. Erion Muharremaj, Prof. Dr. Aurela Anastasin, pedagogë dhe studentë të këtij fakulteti. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i projektit të ndërmarrë nga Departamenti i së Drejtës Publike me titull “Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane përmes gjykimit kushtetues”, i zbatuar me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.



▀ *Konferenca e X-të Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, 13 qershor 2025*

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në Konferencën e X-të Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut me temë “Kufijtë e të Drejtave të Njeriut: Dialogu mes Detyrimeve dhe Lirive”, e organizuar në datën 13 qershor 2025 nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Konferenca mbledhi akademikë, juristë dhe vendimmarrës nga vende të ndryshme për të ndarë së bashku ide, përvoja dhe vizione për të ardhmen mbi këtë tematikë kaq aktuale dhe universale.



▀ *25 – vjetori i krijimit të institucionit të Avokatit të Popullit, 24 qershor 2025*

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në Konferencën më temë “Strukturat Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut: Praktikë e mira dhe Përvojat e fituara”, e organizuar në kuadër të këtij përvjetori duke vlerësuar rolin jetik të këtij institucioni në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit.



Prezantimi i Udhërrëfyesit të Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për periudhën 1992-2024 (Vëllimi II), 14 korrik 2025

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë organizoi ceremoninë e prezantimit të Vëllimit II të Udhërrëfyesit të Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, një botim me rëndësi të veçantë, i cili përmbledh vendimmarrjen e kësaj gjykate për periudhën 1992 – 2024 në lidhje me parimet e së drejtës, ndarjen e pushteteve, si dhe të drejtat kushtetuese substanciale. Ky botim pason vëllimin I të Udhërrëfyesit të Jurisprudencës lidhur me ankimin kushtetues individual (1998–2023), prezantuar në shkurt të vitit 2024. Këto botime do të shërbejnë si një burim i vlefshëm jo vetëm për studiuesit e së drejtës, por edhe si një instrument i rëndësishëm që u vjen në ndihmë pothuajse të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë, dhe veçanërisht gjyqtarëve.

Në aktivitetet nderuan me pjesëmarrjen e tyre, personalitete të institucioneve të pavarura,



të institucioneve të drejtësisë, të sistemit gjyqësor, avokatë, akademikë e profesionistë të së drejtës, ambasadorë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare partnere.

Aktivitet i Këshillit të Evropës, 25 shtator 2025

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Këshilli i Evropës për prezantimin e projektit: *“Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin më të mirë të standardeve të së drejtës për liri dhe siguri në Shqipëri”*. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm drejtues të lartë të institucioneve shtetërore, përfaqësues të organeve të drejtësisë, ambasadorë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe ekspertë të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut.



Takim i trupës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë me delegacionin e kryesuar nga Kryetarja e Gjykatës së Lartë të Holandës, 1 tetor 2025

Trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë mbajti një takim me delegacionin e kryesuar nga Kryetarja e Gjykatës së Lartë të Holandës, zj. Dineke de Groot, në kuadër të vizitës disa ditore që delegacioni holandez zhvilloi në Shqipëri për intensifikimin e dialogut gjyqësor në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European. Palët shkëmbyen mendime për rolin e gjykatave kushtetuese dhe të larta në sistemet respektive, si dhe për limitet e ndërthurjet e juridiksioneve



ndërmjet tyre gjatë interpretimit të Kushtetutës dhe ligjeve.

▀ *Konferencë ndërkombëtare me rastin e 30 viteve të partneritetit me Këshillin e Evropës dhe Komisionin e Venecias, 20 – 21 tetor 2025*

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë “30 vite partneritet dhe progres: Shqipëria, Këshilli i Evropës dhe Komisioni i Venecias”, e cila u organizua nën kujdesin e Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me Komisionin e Venecias dhe Këshillin e Evropës. Konferenca ofroi një mundësi për të shqyrtuar progresin e bërë nga Shqipëria në rrugën e saj të reformave dhe kontributin e Këshillit të Evropës dhe të Komisionit të Venecias në përmirësimin e kuadrit kushtetues dhe ligjor të vendit. Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e Venecias dhe rolin e këtij partneriteti në forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri.



▀ *Tryezë pune për zbatimin e masave të ndërmarra gjatë vitit 2025, 18 – 19 dhjetor 2025*

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare partnere – Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Fondacionin Konrad Adenauer (KAS) – organizoi një tryezë pune me qëllim diskutimin e Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë institucionale të Gjykatës për periudhën 2024-2026, dhe konkretisht, ecurinë e realizimit të masave të planifikuara në kuadër të këtij plan veprimi. Në këtë aktivitet morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, z. Eugen Papandile, përfaqësues të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe të strukturave drejtuese të Gjykatës, si dhe përfaqësuesit e organizatave partnere, znj. Luljeta Krasniqi, këshilltare ligjore vendase në Zyrën e Prezencës së OSBE-së, dhe znj. Zheni Korçari, koordinatore programi e Fondacionit KAS.



